# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5584
E hënë, 24 shtator 2018
çmimi 0.40 €


## Kurti kërkon mobilizim qytetar për protestën e 29 shtatorit
FAQE 7





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", IBRAHIM GASHI FAQE 4-5



# Edhe këtë vit Kosova në OKB nga pozicioni i njëjtë

## - S'mund të presim gjëra të mëdha nga sesioni i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka deklaruar se Kosova duhet të tentojë ta shfrytëzojë Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së për ta shtyrë përpara agjendën e njohjeve, dialogut dhe anëtarësimin në Interpol. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se edhe këtë vit Kosova në këtë forum të rëndësishëm do të marrë pjesë nga pozicioni i njëjtë, jo e barabartë me shtetet e tjera. Prandaj, sipas Gashit, nuk mund të presim gjëra të mëdha në këtë sesion. Ai ka vlerësuar se diplomacia e Kosovës nëpër takimet bilaterale të këtij forumi duhet ta përmendë edhe dialogun me Serbinë për të testuar se sa janë të gatshme shtetet anëtare të OKB-së ta shqyrtojnë anëtarësimin e Kosovës në OKB në rast të arritjes së një marrëveshje me Serbinë

## AKTUALE

### PËRSE HEROI IM ËSHTË FEHMI LLADROVCI F. 11



Bedri ISLAMI

### TAHIRI: VERIU DHE LUGINA E PRESHEVËS JANË TOKA SHQIPTARE, S'MUND TË SHKËMBEHEN F. 3

### HOTI: DIALOGUN DUHET TA UDHËHEQË NJË QEVERI E FUQISHME F. 6

### GRABOVCI KËRKON QË ÇËSHTJA E VETERANËVE TË KTHEHET NË PIKËN ZERO F. 6

## EKONOMI



### MPMS-ja ME MARRËVESHJE PËR AFTËSIM PROFESIONAL F. 8

## KULTURË

### EMIL LAFE DHE 'FJALORI ENCIKLOPEDIK SHQIPTAR' F. 13

Prof. dr. Emin KABASHI

## SPORT

### FLAMURTARI DHE PRISHTINA NJOFTOHEN ME HUMBJE F. 16

### FABIANA BYTYQI, KAMPIONE E BOTËS NË BOKS F. 16

# 'Neni i mëkatit' nga i cili u mohuan qindra pensione kontributpagues

Për shkak të nenit 5, pika 5, të Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr. 09/15, për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve - stazhit pensional - janë qindra pensionistë në Kosovë të cilëve u është mohuar marrja e pensionit në shumën prej 230 eurosh sepse nuk u njihet diploma e fakultetit pas 1. 1. 1991. Disa prej pensionistëve që u mohohet kjo e drejtë përmes gazetës "Epoka e re" kanë paralajmëruar padi në Gjykatën e Strasburgut në qoftë se vazhdojnë të shkelen të drejtat e tyre. Për këtë çështje kanë dhënë përgjigje zyrtarë të MPMS-së, të Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës FAQE 9





## Thaçi i prin delegacionit shtetëror në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së
FAQE 2


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Më 26 shtator protestë në mbrojtje të vlerave të luftës së UÇK-së

Të mërkurën (më 26 shtator), në orën 13:00, OVL UÇK, degët e Dukagjinit, kanë thirrur protestë te Pallati i Drejtësisë në Veternik-Prishtinë, në mbrojtje të vlerave të luftës dhe dinjitetit të luftëtarit të UÇK-së. "Të mërkurën, më 26 shtator 2018, në orën 13:00, protestojmë te Pallati i Drejtësisë në Veternik-Prishtinë, në mbrojtje të vlerave të luftës dhe dinjitetit të luftëtarit të UÇK-së. Ftojmë bashkëluftëtarët dhe të gjithë qytetarët të protestojmë kundër padrejtësisë së radhës që i bëhet luftës së shenjtë të UÇK-së. Faleminderit, Kosovë!", ka shkruar Gazmend Syla në llogarinë e vet në "Facebook", këshilltar për çështje të veteranëve të luftës në kuadër të Zyrës së kryeministrit.

# Thaçi i prin delegacionit shtetëror në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së

Në kuadër të vizitës në Nju Jork, delegacion i Kosovës, nën drejtimin e presidentit Hashim Thaçi, do të zhvillojë takime me liderë dhe përfaqësues të ndryshëm të shteteve që do të jenë pjesëmarrëse në zhvillimin e punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ku në fokus të agjendës do të jetë fuqizimi ndërkombëtar i Kosovës



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka udhëtuar për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku do t'i prijë delegacionit të Kosovës në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.

Presidenti Thaçi, bashkë me zonjën e parë, Lumnije Thaçi, do të marrin pjesë në pritjen e përvitshme të presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, si dhe zonjës së parë, Melania Trump. Gjatë qëndrimit në Nju Jork, presidenti Thaçi do të zhvillojë takime me homologë nga shtete të ndryshme të botës, për ta thelluar bashkëpunimin bilateral dhe rritur numrin e njohjeve shtetërore dhe anëtarësimeve në organizata ndërkombëtare.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për çdo vit mbledh përfaqësuesit e të gjitha shteteve të botës dhe organizatave ndërkombëtare.

Delegacioni i Kosovës gjatë qëndrimit në Nju Jork do të ketë takime të shumta bilaterale me liderë botërorë, përkatësisht me presidentë, kryeministra dhe kryediplomatë të shteteve të ndryshme.

Edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka udhëtuar të dielën për në ShBA, për një vizitë zyrtare në Nju Jork dhe Uashington, ku do të zhvillojë kontakte me zyrtarë të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në kuadër të vizitës në Nju Jork, kryeministri Ramush Haradinaj do të zhvillojë takime me liderë dhe përfaqësues të ndryshëm të shteteve që do të jenë pjesëmarrës në zhvillimin punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe do të kërkojë mbështetjen e të gjithëve që Kosova të jetë pjesë e barabartë e komunitetit ndërkombëtar. "Kosova është e angazhuar ta dëshmojë aftësinë e vet për të qenë kontribuuese në paqen dhe progresin e përgjithshëm global", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj.

Prezantimi i të arriturave të vendit, tërheqja e investimeve të huaja të drejtpërdrejtë, fuqizimi i marrëdhënieve bilatarale me shtetet pjesëmarrëse, takime me homologë nga shtetet evropiane, do të jenë pjesë e agjendës së kryeministrit.

Në fokus të vizitës në ShBA, kryeministri Haradinaj do të qëndrojë edhe në Uashington, ku pritet të ketë takime bilaterale me senatorë e kongresistë dhe personalitete të tjera me influencë në ShBA.

Në takime pritet të diskutohet për thellimin e bashkëpunimit dhe partneritetit të shtetit të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Amerika është partnerja strategjike e Kosovës dhe raportet e zhvilluara deri tani do t'i thellojmë në vazhdimësi", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj. Kryeministri Haradinaj do të zhvillojë aktivitete edhe me komunitetin shqiptar të Amerikës, i cili ka luajtur rol të rëndësishëm në të kaluarën për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, por edhe në proceset nëpër të cilat aktualisht po kalon Kosova.

## Stoltenbergu, Maqedonisë: Dera është e hapur, ju presim në NATO



BRUKSEL, 23 SHTATOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, përmes një videomesazhi drejtuar qytetarëve të Maqedonisë ka përsëritur se dyert e NATO-s janë të hapura dhe se në të mund të kalohet vetëm pas një referendumi të suksesshëm. Sipas Stoltenbergut, anëtarësimi në aleancën e NATO-s do ta rrisë stabilitetin duke e bërë Maqedoninë një vend më të sigurt. "Marrëveshja historike për çështjen e emrit e ka hapur mundësinë për anëtarësim të plotë në komunitetin ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe anëtarësim të plotë në NATO. Anëtarësimi në NATO do t'ju japë juve dhe fëmijëve tuaj sigurinë që vjen si pasojë e të qenit pjesë e aleancës më të suksesshme në botë dhe do t'i japë shtetit tuaj zë të barabartë në diskutimet tona dhe sqarim të barabartë në vendimet tona. Tani është koha që të dëgjohet zëri juaj. Kjo është mundësi gjë vjen 'Një herë në jetë'. Dera e NATO-s është e hapur, por vetëm njerëzit e shtetit tuaj mund të vendosin që të kalojnë mes saj, ka theksuar Jens Stoltenberg, sekretar i përgjithshëm i NATO-s.

## Ahmeti: Pas 15 muajve do të jemi anëtar i NATO-s



SHKUP, 23 SHTATOR - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti ka deklaruar se pas 15 muajsh do të jemi anëtarë, gjegjësisht shteti i 30 në NATO, duke siguruar ardhmërinë e Maqedonisë, një ekonomi shumë të përparuara, njëherësh duke parandaluar migrimin e të rinjve, e cila bëhet duke krijuar standarde në Maqedoni.

Ahmeti i bëri këto komente në komunën e Tearcës, ku është bërë thirrje që në mënyrë sa më masive më 30 shtator për referendum të përcaktohen për opsionin e ardhmërisë, për opsionin që shpie në anëtarësim në NATO. Ai theksoi para të pranishmëve se me Marrëveshjen e Prespës u hapën dyert për në NATO dhe BE dhe me këtë marrëveshje ka fituar paqja. "Me anëtarësimin në NATO, fitorja është te siguria, stabiliteti. Duke mos i pasur këto të dyja nuk ke zhvillim ekonomik dhe çdo investitor vendës apo i huaj kërkon në radhë të parë a ka siguri, a ka stabilitet. Ne bëhemi më të rëndësishëm duke qenë pranë këtyre strukturave, pranë strukturës më të madhe politiko-ushtarake NATO bëhemi më të rëndësishëm, më të dobishëm për ekonominë e vendit, duke qenë pjesë edhe e Bashkimit Evropian. Pas 15 muajsh do të jemi anëtar, gjegjësisht shteti i 30 në NATO", u shpreh Ali Ahmeti.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri, vazhdon ta kundërshtojë idenë për korrigjimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë

# Tahiri: Veriu dhe Lugina e Preshevës janë toka shqiptare, s'mund të shkëmbehen

"Shqiptarët mund të bëhen bashkë me një shtet duke forcuar sundimin e ligjit dhe ekonominë, e jo duke dhënë toka shqiptare", kështu ka deklaruar të dielën ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri. Në këtë kontekst ajo ka thënë se veriu i Kosovës dhe Lugina e Preshevës janë toka shqiptare dhe, si të tilla, nuk mund të shkëmbehen

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 23 shtator** - Ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri, ka thënë të dielën se shqiptarët mund të bëhen bashkë me një shtet duke forcuar sundimin e ligjit dhe ekonominë, e jo duke dhënë toka shqiptare. Ajo ka theksuar se veriu i Kosovës dhe Lugina e Preshevës janë toka shqiptare dhe, si të tilla, nuk mund të shkëmbehen. "Shqiptarët bëhen krejt me një shtet, kur forcojmë ekonominë dhe sundimin e ligjit, e jo duke dhënë toka shqiptare. Edhe veriu i Kosovës edhe Lugina e Preshevës janë toka shqiptare. Ato nuk mund të shkëmbehen", ka shkruar Tahiri në llogarinë e saj në "Facebook".

Më tutje, ajo ka deklaruar se falë procesit të dialogut të zhvilluar me Serbinë është arritur shuarja e strukturave paralele në veri si dhe është vendosur sovraniteti i shtetit të Kosovës. Tahiri ka rikujtuar se pikërisht në veri janë "Trepça" dhe Ujmani që, sipas saj, janë fuqi gjeopolitike të Kosovës. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se për këto pasuri natyrore Serbia e ka mbajtur Kosovën të kolonizuar 100 vjet. "Me dialogun e Brukselit, të cilin e kam udhëhequr unë, kemi arritur sukses që në pjesën veriore të Kosovës të vendosim sovranitetin e shtetit të Kosovës, të veprojnë ligjet dhe institucionet e Kosovës, ndërsa janë shuar strukturat paralele serbe. Mos harroni se në veri janë 'Trepça', miniera më e pasur në Evropë, resurset e ujit/Ujmani etj., që janë fuqi gjeopolitike e Kosovës. Për këto pasuri natyrore Serbia ka mbajtur Kosovën të kolonizuar 100 vjet për t'i shfrytëzuar pasuritë tona. Në vitin 1999 e dëbuam Serbinë, dhe këto pasuri tashmë janë në shërbim të zhvillimit ekonomik të Kosovës. E paskëshit harruar thënien e popullit dhe minatorëve: 'Trepça punon, Beogradi ndërton'", ka theksuar Tahiri. Ajo ka thënë se tokat shqiptare nuk mund të tkurren më tej dhe këtë, sipas Tahirit, nuk mund ta bëjë askush.

Tahiri ka vlerësuar se kur të vijë koha e ndryshimit e të gjithë kufijve në Ballkan atëherë do të vijë edhe bashkimi kombëtar. "Eh, kjo është temë tjetër, sa jemi të zotët. Por tokat shqiptare nuk mund të tkurren më tej. Këtë nuk mund ta bëjë askush. Kur të vijë koha e ndryshimit e të gjithë kufijve në Ballkan atëherë vjen bashkimi kombëtar. Po ju kujt po ia lini shqiptarët e tjerë që i kemi në Maqedoni e Mal të Zi etj? Edhe vetë udhëheqësit e shqiptarëve të Luginës së Preshevës kanë thënë se e duan bashkimin me Kosovën që në vitin 1992, por jo duke e këmbyer me veriun e Kosovës. Pra, janë deklaruar ashtu siç duhet, duke mbrojtur interesat kombëtare. Ju vetë duhet të analizoni dhe mendoni për këto çështje, unë nuk synoj t'ua ndërroj mendjen, sepse kjo duhet të vijë nga vetë ju, si një parim demokracie", është shprehur më tutje Tahiri, duke shtuar se nuk ka vend për frikë meqë Kosova e ka fituar luftën kundër Serbisë në vitin 1999 së bashku me aleatët tanë amerikanë dhe perëndimorë. Ajo ka thënë se kufijtë e vitit 1974 janë baza juridiko-kushtetuese me të cilën Kosova



ka fituar pavarësinë dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka konfirmuar se pavarësia e Kosovës është e ligjshme. "Mos u frikësoni se frika neve na la 100 vjet të ndarë e të pushtuar. Tash e kemi kryer, kemi fituar luftën kundër Serbisë në vitin 1999, së bashku me aleatët tanë amerikanë e perëndimorë. Nuk ka vend për fikë, sa frikësoheni më mirë mendoni thellë për interesat kombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare. Çdo datë nuk është valide në të drejtën ndërkombëtare, kufijtë e 1974-s janë baza juridiko-kushtetuese me të cilën Kosova ka fituar pavarësinë dhe Gjykata Ndërkombëtare për drejtësi ka konfirmuar se pavarësia e Kosovës është e ligjshme. Këto punë nuk bëhen odave me muhabete të lira, por me ligje me të cilat vepron bota", ka deklaruar ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri.

# Kelmendi: Protesta e Vetëvendosjes forcon edhe më shumë presidentin Thaçi

**Prishtinë, 23 shtator (ER)** - Kryetari i Partisë Fjala, Gëzim Kelmendi, ka thënë se protesta e thirrur nga Lëvizja Vetëvendosje e forcon edhe më shumë pozicionin dhe autoritetin e presidentit Hashim Thaçi. "Vetë motoja e LV-së 'Një popull s'i nënshtrohet një njeriu' synon ta tregojë autoritetin e presidentit Thaçi. Por, jo, presidenti Thaçi nuk mund të vendosë asgjë për popullin e Kosovës në këtë rast. Edhe pse ai po insiston në idenë e tij për korrigjim të kufijve, presidenti Thaçi asgjë nuk mund të vendosë, ngaqë për të realizuar marrëveshje ndërkombëtare i duhen votat e 2/3 të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, i duhen votat e 80 deputetëve. Kështu që kjo ide e presidentit Thaçi aktualisht është e pamundur të realizohet. Vetë koalicioni qeverisës i ka 60 deputetë, edhe pse brenda vetë koalicionit ka kundërshtime për këtë ide. Pastaj LDK-ja është kategorikisht kundër korrigjimit të kufijve. Kështu që, kjo protestë nuk është e qëlluar", ka thënë Kelmendi. Ai ka thënë se protesta e 29 shtatorit është më shumë për poenë politikë, pas goditjeve të brendshme që, sipas tij, ka marrë Vetëvendosja.



Flet për "Epokën e re", Ibrahim Gashi

# Edhe këtë vit Kosova në O



## - S'mund të presim gjëra të mëdha nga sesioni i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka deklaruar se Kosova duhet të tentojë ta shfrytëzojë Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së për ta shtyrë përpara agjendën e njohjeve, dialogut dhe anëtarësimin në Interpol. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se edhe këtë vit Kosova në këtë forum të rëndësishëm do të marrë pjesë nga pozicioni i njëjtë, jo e barabartë me shtetet e tjera. Prandaj, sipas Gashit, nuk mund të presim gjëra të mëdha në këtë sesion. Ai ka vlerësuar se diplomacia e Kosovës nëpër takimet bilaterale të këtij forumi duhet ta përmendë edhe dialogun me Serbinë për të testuar se sa janë të gatshme shtetet anëtare të OKB-së ta shqyrtojnë anëtarësimin e Kosovës në OKB në rast të arritjes së një marrëveshje me Serbinë

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka bërë me dije se nuk mund të priten gjëra të mëdha për Kosovën nga sesioni i 73-të i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Ai ka deklaruar se edhe këtë vit Kosova në OKB do të jetë nga pozicioni i njëjtë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se, përveç njohjeve, diplomacia e Kosovës në takimet bilaterale duhet të flasë për dialogun me Serbinë dhe çështjen e anëtarësimit në Interpol. "Mendoj se përmendja e dialogut duhet bërë sa për të testuar sa janë të gatshme shtetet anëtare të OKB-së që në rast të arritjes së një marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë ta shqyrtojnë seriozisht anëtarësimin e Kosovës në OKB. Këtu mendoj duhet testuar cili do të ishte qëndrimi i Kinës dhe i Rusisë në rast se krijohet një momentum i ri në marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Gashi. Megjithatë, Gashi ka pranuar se kjo është diçka që jo plotësisht mund të parashikohet në mënyrë hipotetike. "Pra, është vështirë që me siguri të plotë, në rast të një marrëveshje Kosovë - Serbi, Kina dhe Rusia të lëvizin nga pozicionet e tyre kundërshtuese karshi anëtarësimit të Kosovës në OKB. Në këtë funksion, mendoj unë, duhet të përmendet tema e dialogut në këtë forum. Një gjë është e qartë, se edhe këtë vit Kosova do të jetë në OKB nga pozicioni i njëjtë, ndaj s'mund të presim gjera të mëdha", ka thënë Gashi.

Ai i ka ftuar institucionet e Kosovës që në lobimin gjatë këtij sesionit të asamblesë të fokusohen edhe në çështjen e anëtarësimit të Kosovës në Interpol. "Unë uroj që këtë vit të jenë bërë tashmë përgatitjet dhe kontaktet e nevojshme për ta marrë mbështetjen e shumicës së shteteve anëtare për anëtarësim në Interpol. Natyrisht edhe në kuadrin e këtij sesioni duhet të punohet me shtetet veç e veç për të realizuar këtë synim. Nuk mund të them me siguri të plotë se do të anëtarësohemi, pra kam një fije optimizmi se kjo do të ndodhë", ka deklaruar Gashi. Ndonëse e pabarabartë me shtetet e tjera, diplomacia e Kosovës, sipas Gashit, duhet ta shfrytëzojë këtë forum, kryesisht për ta shtyrë përpara agjendën e njohjeve, duke zhvilluar takime me burrështetas të shteteve të ndryshme, edhe të atyre vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën.

**"Epoka e re":** *Z. Gashi, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka filluar punimet. Ky forum ndërkombëtar shihet si një mundësi e mirë për diplomacitë botërore që t'i shtyjnë përpara interesat e tyre. Çfarë duhet të bëjë diplomacia e Kosovës?*

**Gashi:** Në javën në të cilën po hyjmë, nga 24 shtatori deri më 1 tetor, do të zhvillohen takimet e nivelit të lartë në kuadër të sesionit të 73-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Temat e debatit do të jenë kryesisht të interesit global, si: Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm, parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve jongjitëse, komemorimi dhe promovimi i ditës për eliminimin total të armëve nukleare dhe tema të tjera. Sigurisht, përveç këtyre temave të mëdha, në këtë forum ndodhin dhjetëra takime formale e joformale ku diskutohen edhe tema të tjera. Shtetet e veçanta e shfrytëzojnë këtë forum për të diskutuar edhe për tema të ndryshme të karakterit bilateral apo regjional. Natyrisht edhe diplomacia e Kosovës, edhe pse merr pjesë në një format jo të barabartë me shtetet e tjera, tash e një kohë të gjatë është munduar ta shfrytëzojë këtë takim të rëndësishëm shumëpalësh, kryesisht për ta shtyrë përpara agjendën e njohjeve, duke zhvilluar takime me burrështetas të

# OKB nga pozicioni i njëjtë



shteteve të ndryshme, edhe të atyre vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën, por që këtu në margjina të konferencës kanë pranuar të takohen më përfaqësuesit e Kosovës. Mendoj se kjo përpjekje duhet të vazhdojë nga diplomacia jonë edhe këtë vit. Është shumë me rëndësi që paraprakisht nga misioni ynë diplomatik në Nju Jork dhe në Uashington të jenë aranzhuar sa më shumë takime për delegacionin tonë.

**"Epoka e re":** *Siç dihet këto raste diplomacia serbe i shfrytëzon mjaft mirë për ta kundërshtuar çështjen e njohjeve për Kosovën. Si duhet të reagojë Kosova ndaj këtyre veprimeve të shtetit serb?*
**Gashi:** Diplomacia serbe është në pozitë më të favorshme për të vepruar në këtë forum nga pozicioni i të qenit anëtar i OKB-së. Diplomatët serbë i kanë më të lehta takimet, kanë qasje në të gjitha takimet që zhvillohen në kuadër të këtij sesioni. Kanë më shumë qasje në media. Sigurisht nga diplomacia jonë duhet shumë dinamikë dhe energji për ta shfrytëzuar çdo mundësi për t'i takuar gjithë ata përfaqësues me të cilët takohen diplomatët serbë për ta minuar pozicionin e shtetit të Kosovës.

**"Epka e re":** *Këtë vit prioritet i Kosovës është anëtarësimi në Interpol. Do të duhej që diplomacia jonë të fokusohej në lobim rreth kësaj çështje?*
**Gashi:** Uroj që këtë vit të jenë bërë tashmë përgatitjet dhe kontaktet e nevojshme për ta marrë mbështetjen e shumicës së shteteve anëtare për anëtarësim në Interpol. Edhe në kuadrin e këtij sesioni duhet të punohet me shtetet veç e veç për të realizuar këtë synim. Nuk mund të them më siguri të plotë se do të anëtarësohemi, par kam një fije optimizmi se kjo do të ndodhë.

**"Epoka e re":** *Prej shpalljes së pavarësisë, sa mendoni se i ka shfrytëzuar Kosova mbledhjet e asamblesë së OKB-së?*
Gashi: Këto takime vjetore në OKB diplomacia dhe politika e Kosovës i ka shfrytëzuar deri diku. Janë zhvilluar shumë takime joformale në margjina të konferencës nga të cilat kemi pasur si impakt të drejtpërdrejtë arritjen e njohjeve të reja. Nuk mund të themi se është shfrytëzuar maksimalisht çdo mundësi që ofrohet këtu. Sigurisht se ka mundur të bëhet më tepër kur kihet parasysh se delegacioni i Kosovës që ka udhëtuar në fund të shtatorit në Nju Jork ka qenë numerikisht i madh.

**"Epoka e re":** *Kosova është në prag të fillimit të fazës finale të dialogut me Serbinë. Gjatë punimeve të asamblesë së OKB-së, krerët e shtetit të Kosovës a do të duhej ta adresojnë edhe këtë çështje?*
**Gashi:** Përmendja e dialogut duhet bërë sa për të testuar sa janë të gatshme shtetet anëtare të OKB-së që, në rast të arritjes së një marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë, ta shqyrtojnë seriozisht anëtarësimin e Kosovës në OKB. Këtu mendoj duhet testuar cili do të ishte qëndrimi i Kinës dhe i Rusisë në rast se krijohet një momentum i ri në marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë. Kjo është diçka që jo plotësisht mund të parashikohet në mënyrë hipotetike. Pra, është vështirë që me siguri të plotë, në rast të një marrëveshje Kosovë - Serbi, Kina dhe Rusia të lëvizin nga pozicionet e tyre kundërshtuese karshi anëtarësimit të Kosovës në OKB. Në këtë funksion, mendoj unë, duhet të përmendet tema e dialogut në këtë forum. Një gjë është e qartë, se edhe këtë vit Kosova do të jetë në OKB nga pozicioni i njëjtë, ndaj dhe s'mund të presim gjëra të mëdha.

## Serbia i ka shkaktuar Kosovës mbi 22 miliardë euro dëme të luftës

**Prishtinë, 23 shtator** - Mbi 22 miliardë euro llogariten dëmet e luftës që Serbia ka shkaktuar në Kosovë para dhe gjatë luftës së fundit (1990-1999), kanë thënë zyrtarë të Qeverisë dhe analistë në Prishtinë. Por, kompensimi për dëmet e luftës deri më tani nuk është diskutuar gjatë dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë që është zhvilluar në Bruksel, me lehtësimin e Bashkimit Evropian.
Aktualisht Kosova dhe Serbia janë futur në fazën finale të dialogut, në të cilën është paralajmëruar edhe arritja e një marrëveshjeje finale që do ta nënkuptonte normalizimin e raporteve ndërmjet dy vendeve ndërkaq, sipas analistëve, në agjendën e bisedimeve duhet patjetër të diskutohet edhe për dëmet e luftës.
Edhe pse kjo çështje nuk është trajtuar në bisedimet në Bruksel, kjo temë ishte ngritur një herë në procesin e negociatave të Vjenës, që janë mbajtur para shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Por, kjo temë qe mbyllur menjëherë, pasi pala serbe një kërkesë të tillë nuk e ka pranuar.
Muhamet Mustafa nga Instituti "Riinvest" ka qenë koordinator i ekipit për çështje ekonomike në Grupin Negociator në Vjenë. Mustafa, tashmë këshilltar i lartë në këtë institut, ka thënë se është kërkuar që kjo çështje të trajtohet edhe në bisedimet që janë zhvilluar në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, në procesin e dialogut që ka filluar nga viti 2011. Ai ka thënë se për normalizim të marrëdhënieve mes dy vendeve nevojitet që Serbia t'i kompensojë dëmet e luftës. "Ekipi i ekspertëve që kam udhëhequr unë në atë kohë ka bërë një vlerësim të dëmeve të luftës për sektorë të ndryshëm, e që vlera ka arritur në mbi 22 miliardë euro. E tash natyrisht për t'u krijuar një pajtim, dhe për të parë që Serbia me të vërtetë dëshiron që të lë prapa vetës politikën e (Sllobodan) Milloshevigit, ajo duhet të jetë e gatshme t'i spastrojë llogaritë dhe dëmet ekonomike në pronën private dhe dëmet e tjera që i ka shkaktuar Kosovës me qeverisjen e saj dhe luftën shfarosëse që ka zhvilluar ndaj shqiptarëve. Unë personalisht mendoj se për një pastrim të llogarive, për një pajtim, krahas kërkimit të faljes për dëmet, ato dëme duhet të zhdëmtohen", ka thënë Mustafa.
Ndërsa Haki Shatri, këshilltar për ekonomi në Qeverinë e Kosovës, i cili në atë kohë ka qenë pjesë e ekipit në Vjenës, ka thënë se faktori ndërkombëtar vazhdimisht ka hezituar që kjo çështje të trajtohet. Por, Shatri ka thënë se kompensimi i dëmeve të luftës gjithsesi duhet të trajtohet në kuadër të bisedimeve që po zhvillohen në Bruksel. "Mendoj se delegacioni i Kosovës në agjendën e bisedimeve në këtë fazë duhet të rendisë edhe këtë çështje si pikë e veçantë të bisedimeve me palën serbe", ka thënë Shatri.
Muhamet Mustafa është shprehur se Republika e Kosovës nuk duhet të heqë dorë nga shpagimi i dëmeve të luftës. Ai konsideron se edhe pas përmbylljes së negociatave Kosova duhet ta padisë Serbinë për dëmet e luftës. "Natyrisht se Kosova duhet të sheh edhe mundësitë tjera. Ndonëse Kosova ende nuk është anëtare e Gjykatave Ndërkombëtare, për shkak të pozitës së saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, por nuk është se nuk ka ndonjë hapësirë. Mendoj se Kosova duhet të trajtojë, duhet të angazhojë ekipe ekspertësh për të parë se si në mënyrën më të mirë dhe në vendin më adekuat mund të bëhet dhe të ekzekutohet kjo padi", ka thënë Mustafa për "Radion Evropa e Lirë".
Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës më herët patën deklaruar se padia do të ngrihej kur Kosova do të mund ta bënte këtë si vend anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara.



# Hoti: Dialogun duhet ta udhëheqë një qeveri e fuqishme

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë të dielën se dialogu me Serbinë nuk mund të udhëhiqet nga një qeveri e pakicës që, sipas tij, diktohet në veprime nga vullneti i partnerëve të vegjël të cilët e mbajnë në këmbë. "Kryeministri nuk ka asnjë fuqi politike për të udhëhequr këtë proces, e as fuqi për të deleguar këtë autoritet te dikush tjetër", ka thënë Hoti



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se Qeveria e Kosovës që drejtohet nga kryeministri Ramush Haradinaj nuk mund ta udhëheqë dialogun e as ta delegojë këtë autoritet te dikush tjetër pasi, sipas tij, Kosova ka qeveri të pakicës. Hoti ka theksuar se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, duhet të udhëhiqet nga një qeveri e fuqishme "me bazë të gjerë". "Dialogu mund të udhëhiqet vetëm nga institucione përfaqësuese dhe legjitime, që flasin në emër të shumicës së qytetarëve të Kosovës. Dialogu nuk mund të udhëhiqet nga një qeveri e pakicës, që diktohet në veprime nga vullneti i partnerëve të vegjël të cilët e mbajnë në këmbë. Kryeministri nuk ka asnjë fuqi politike për ta udhëhequr këtë proces, e as fuqi për të deleguar këtë autoritet te dikush tjetër. Është e qartë se ai mund të flasë vetëm në emrin e partisë së tij, por jo në emër të Qeverisë e cila është copëtuar në zona të interesit", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se udhëheqjen e dialogut duhet ta marrë përsipër një qeveri e fuqishme me bazë të gjerë, bazuar në mandat të qartë nga Kuvendi i Kosovës. "Kjo mund të arrihet vetëm pas zgjedhjeve të lira, të cilat do të prodhojnë një qeveri stabile. Në qeverinë e ardhshme, të udhëhequr nga LDK-ja, ne do të punojmë, sado që është e nevojshme, me të gjitha forcat politike për të arritur konsensus për dialogun. Sepse ky proces nuk i takon vetëm një partie apo vetëm Qeverisë", ka thënë Hoti.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011. Dialogun në nivel politik që prej nisjes së tij e ka udhëhequr Hashim Thaçi, njëherë nga posti i kryeministrit, tash edhe nga posti i presidentit.

Partitë opozitare po refuzojnë propozimin e Qeverisë së Kosovës për ekipin negociator për dialogun. Qeveria ka propozuar që në krye të këtij ekipi të jetë zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, ndërkaq në të opozita dhe shoqëria civile t'i dërgojnë përfaqësuesit e tyre.

Bashkimi Evropian kërkon që në fund të procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë të arrihet një marrëveshje për normalizimin e raporteve, e cila, veç të tjerash, do t'u hapë rrugë drejt integrimeve evropiane të dy shteteve.

# Zëvendësministri Ramadani: Transformimi i FSK-së në ushtri zgjatë dhjetë vjet

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Njohësit e çështjeve të sigurisë kanë thënë se është larguar çdo dilemë nëse deputetët serbë do ta përkrahin krijimin e ushtrisë së Kosovës. Siç dihet tanimë, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë nisur procedurat për transformimin e FSK-së në ushtri, pavarësisht se kjo mund të përdoret si argument nga Serbia, se ushtria po bëhet pa pëlqimin e serbëve të Kosovës.

Ditë më parë një raport i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka treguar se largimet masive të pjesëtarëve serbë të FSK-së janë orkestruar nga elemente të inteligjencës ushtarake nga Beogradi dhe Vranja.

Ky konstatim është parë nga autori i raportit, Shpat Balaj, si tendencë për rrëzimin e shumetnicitetit. "Rrjedhimisht këto veprime kanë larguar çdo dilemë se Lista Serbe do t'i përkrahë ndonjëherë ndryshimet kushtetuese për transformimin e FSK-së". FSK-ja është e ndërtuar mbi parimin



e shumëllojllojshmërisë dhe shumetnicitetit, prandaj mosndryshimi i Kushtetutës në këtë aspekt nuk tregon se është duke u formuar një ushtri shqiptare. Bashkësia ndërkombëtare insiston të këtë gjithëpërfshirje në çdo proces në Kosovë. Por, bashkësia ndërkombëtare e ka edhe të qartë se Lista Serbe është e pamundshme ta votojë transformimin e FSK-së", ka thënë Balaj. Ndërsa politologu Ramush Tahiri ka thënë se kjo tashmë dihet se shteti serb ka ndikim në jetën e serbëve të Kosovës.

Rrëzimi i shumetnicitetit, i synuar nga Serbia, sigurisht për t'u përdorur si argument nga ana e saj, se ushtria po krijohet pa pëlqimin dhe pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës, nuk shihet si problem nga drejtuesit e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Zëvendësministri i FSK-së, Burim Ramadani, i ka thënë "Radio Kosovës" se transformimi i FSK-së do të nisë tani dhe do të zgjasë dhjetë vjet, derisa do të njihet nga të gjitha vendet që e kanë njohur Kosovën shtet. "Ne kemi punuar në vazhdimësi me shtetet partnere dhe me organizatat partnere. Ushtria, respektivisht FSK-ja, me mandat ushtarak e fillon tranzicionin tashpo , do t'i marrë 10 vjet proces të përmbylljes së këtij tranzicioni", ka thënë Ramadani.

Qeveria ditë më parë ka proceduar Projektligjin për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, kurse faktori ndërkombëtar ka vazhduar të përsërisë se do ta përkrahë këtë proces vetëm përmes ndryshimeve kushtetuese, ku kërkohen edhe 2/3 e votave të deputetëve të pakicave.

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe sekretarja organizative, Vlora Haxhimehmedi, kanë mbajtur konferencë për medie

# Kurti kërkon mobilizim qytetar për protestën e 29 shtatorit

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se protesta e 29 shtatorit kërkon ndalimin e pazareve Thaçi - Vuçiq, kundërshton aspiratat e Serbisë në Kosovë dhe insiston në legjitimitet të ri përmes zgjedhjeve të reja parlamentare. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve t'i bashkohen kësaj proteste në orën 14:00 te Biblioteka Kombëtare, duke thënë se nëpërmjet protestës paqësore e masive do t'i tregohet botës se populli i Kosovës, për dallim nga presidenti Thaçi, nuk i ka rënë pishman pavarësisë së Kosovës

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, të dielën u ka bërë thirrje qytetarëve t'i bashkohen protestës së 29 shtatorit në orën 14:00 te Biblioteka Kombëtare.

Ai ka thënë se protesta ka për qëllim ndalimin e pazareve Thaçi - Vuçiq si dhe insiston në legjitimitet të ri përmes zgjedhjeve të reja parlamentare. "Kjo protestë kërkon ndalimin e pazareve Thaçi - Vuçiq, kundërshton aspiratat e Serbisë në Kosovë dhe insiston në legjitimitet të ri përmes zgjedhjeve të reja parlamentare kur gjendja ekonomike është kaq e rëndë, ndërkaq krimi dhe korrupsioni nuk kanë të ndalur", ka deklaruar Kurti në një konferencë të përbashkët për medie me sekretaren organizative, Vlora Haxhimehmedi.

Kurti ka bërë me dije se kjo nuk është protestë e Vetëvendosjes, por e qytetarëve të republikës për Republikën e Kosovës. Ai ka theksuar se nëpërmjet protestës paqësore e masive, në të cilën do të ketë edhe grupe muzikore, do t'i tregohet botës, veçanërisht shteteve që na kanë njohur, se populli i Kosovës, për dallim nga presidenti Thaçi, nuk i ka rënë pishman pavarësisë së Kosovës. "Protesta po bëhet, le të themi, me iniciativën e Lëvizjes Vetëvendosje, por kjo nuk është protestë e Vetëvendosjes. Kjo është protestë e qytetarëve të Republikës së Kosovës për Republikën. Në kushtet kur kemi krizë institucionale, kur Qeveria bojkoton Kuvendin sepse bllokon opozitën, atëherë rruga e sheshi janë opsione si asnjëherë më parë dhe ajo që është publike është e Republikës. Prandaj, mendojmë se qytetarët duhet ta shprehin pakënaqësinë dhe vullnetin e tyre në shesh të Republikës në protestën e së shtunës, më 29 shtator. Nëpërmjet protestës paqësore e masive, në të cilën do të ketë edhe grupe muzikore, do t'i tregohet botës, veçanërisht shteteve që na kanë njohur, se populli i Kosovës, për dallim nga presidenti Thaçi, nuk i ka rënë pishman pavarësisë së Kosovës", ka deklaruar Kurti.

Sipas tij, pazaret e presidentit Hashim Thaçi me homologun e tij serb Aleksandër Vuçiq, për copëtimin e Republikës, duhet të ndalen. "Vendgrumbullimi është para Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare, pastaj vazhdon marshi paqësor në rrugën 'Eqrem Qabej', kthehemi te bulevardi 'Xhorxh Bush', vazhdojmë te Bulevardi 'Nëna Terezë' dhe deri te Teatri Kombëtar, Sheshi 'Skënderbe' dhe Sheshi 'Ibrahim Rugova'. Pra, kjo është marshi ynë për të shtunën e ardhshme, me ç'rast i ftojmë të gjithë qytetarët, pa dallim moshe e gjinie, por edhe pa dallim partie që të bëhen bashkë në këtë protestë, e cila kërkon ndalimin e pazareve Thaçi - Vuqiç", ka thënë Kurti.




Ndërsa i pyetur nëse LV-ja do të pranonte të bëhet pjesë e një ekipi negociator për dialogun me Serbinë, Kurti ka theksuar se dialogu duhet të ndalet kësisoj si është, dhe se shteti i Kosovës së pari duhet të bëjë një listë me krejt borxhet që Serbia ia ka Kosovës, duke përfshirë të pagjeturit, gratë e vajzat e dhunuara, artefaktet e vjedhura e shumë e shumë të tjera.

Ndërsa sekretarja organizative e LV-së, Vlora Haxhimehmedi, ka folur për domosdoshmërinë e protestës në kohën kur presidenti Thaçi ecën me hapa të shpejtë drejt copëtimit të Kosovës, ndërkohë Vuçiqi mbështet dhe promovon projektet e Millosheviqit. "Në këtë protestë i ftojmë të gjitha subjektet politike dhe anëtarët e aktivistët e tyre, shoqërinë civile dhe të gjithë qytetarët të na bashkohen, të gjithë ata që e duan një shtet të drejtë dhe sovran", është shprehur Haxhimehmedi.

## Grabovci kërkon që çështja e veteranëve të kthehet në pikën zero

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Një nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Adem Grabovci, ka folur për numrin e veteranëve të UÇK-së, për publikimin e listës së veteranëve dhe zgjidhjen e këtij problemi. Ai ka thënë se në listën e publikuar ka parë shumë veteranë që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në luftën e UÇK-së. "T'ju them të drejtën, publikimi i këtyre listave nuk besoj se na ka bërë të ndihemi mirë dhe krenarë. Nuk dua të lëshohem shumë në atë se kush është veteran i vërtetë apo kush nuk është i tillë, por në këto lista kam parë veteranë të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në çlirimin e Kosovës. Një trajtim i tillë i kësaj çështjeje kaq të ndjeshme nuk i bën nder askujt, aq më pak luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe bartësve të kësaj lufte", ka thënë Grabovci në një intervistë për "FaktePlus".

Anëtari i Kryesisë së PDK-së mendon se këtë problem nuk e zgjidh drejtësia, derisa ka dhënë një propozim se si do të zgjidhej kjo çështje. "Nuk besoj se drejtësia mund t'i japë zgjidhje kësaj teme kaq të ndjeshme. Unë mendoj se zgjidhja e kësaj teme është rikthimi në pikën zero. Pra, kjo çështje duhet të trajtohet nga fillimi. Në këtë proces nuk mund të ketë përgjegjësi kolektive, por individuale. Aty ku ka pasur lëshime duhet të ketë edhe përgjegjësi", ka thënë Grabovci.



# ‘Neni i mëkatit’ nga i cili u mohuan

Për shkak të nenit 5, pika 5, të Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr. 09/15, për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve - stazhit pensional - janë qindra pensionistë në Kosovë të cilëve u është mohuar marrja e pensionit në shumën prej 230 eurosh sepse nuk u njihet diploma e fakultetit pas 1. 1. 1991. Disa prej pensionistëve që u mohohet kjo e drejtë përmes gazetës "Epoka e re" kanë paralajmëruar padi në Gjykatën e Strasburgut në qoftë se vazhdojnë të shkelen të drejtat e tyre. Për këtë çështje kanë dhënë përgjigje zyrtarë të MPMS-së, të Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 23 shtator** - Hasan Hasanramaj dhe Syhejl Havolli janë vetëm dy nga mijëra pensionistë të cilët kanë diploma universitare e që privohen nga marrja e pensionit prej 58 eurosh më shumë për shkak të Udhëzimit Administrativ (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-MPMS), nr. 09/15, për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve - stazhit pensional.

Është pikërisht neni 5, pika 5 e këtij udhëzimi, që mijëra pensionistëve në Kosovë ua privon marrjen e pensionit prej 58 eurosh më shumë, pasi nuk u njihet diploma universitare e marrë pas 1. 1. 1991. "Neni 5: Kualifikim i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues. 1. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të ulët, konsiderohet i siguruari ose pensionisti kontributpagues, pa ose me përgatitje shkollore të ulët; 2. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të mesme konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer shkollën e mesme; Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të lartë, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili e ka të kryer shkollën e lartë; Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore superior, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili e ka të kryer fakultetin apo studimet pasuniversitare. Të gjitha dëshmitë për kualifikime, të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 1. 1. 1991", specifikohet në udhëzimin administrativ (MPMS), nr. 09/15 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve - stazhit pensional.

Ndërkaq, ky nen bie ndesh me Ligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti pasi, sipas nenit 3, pika 1.5, "pension kontributpagues i moshës - pensioni i rregullt mujor për qytetarët e punësuar në Republikën e Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 1. 1. 1999 sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83), të cilët i plotësojnë kriteret e paraparë me këtë ligj", specifikohet në Ligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Po ashtu, ky udhëzim është në kundërshtim edhe me nenin 8, pikën 1.2, ku janë të përcaktuara kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës, pika 1.2, që thotë se "duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 26/83) para datës 1.01.1999".



Pensionisti Hasan Hasanramaj, i cili studimet i ka mbaruar më 18 nëntor 1991, në Universitetin e Prishtinës në Fakultetin e Filozofisë, Departamentin e Historisë, u privua nga e drejta e marrjes së pensionit në shumën prej 230 eurosh siç është për pensionistët me fakultet, pasi me anë të këtij neni nuk i njihet diploma e fakultetit, duke bërë që ai të marrë 58 euro më pak, pra shumën prej 172 eurosh.

Hasanramaj, i cili ishte arsimtar dhe gazetar në gazetën "Bota sot", ka thënë për gazetën "Epoka e re" se me anë të këtij neni është bërë mëkat i madh me pensionistët, duke u ndalur paratë e pensionit për të cilat kanë kontribuar. Ai ka thënë se institucionet e shtetit me qëllim e kanë vënë këtë kufizim, në mënyrë që paratë e pensionistëve t'i destinojnë diku tjetër.

Madje ai ka hedhur dyshime se këtë e kanë bërë pasi Serbia ka plaçkitur Fondin Pensional të Kosovës dhe, në saje të kësaj plaçkitje, sipas tij, këtë po e paguajnë pensionistët kontributdhënës. "Ne nuk kemi faj pse Serbia e plaçkiti Fondin e Kursimeve Pensionale. Janë me qindra pensionistë të cilëve ua mohuan të drejtën në këtë mënyrë për shkak të hesapeve të tyre buxhetore", është shprehur ai.

Pensionisti Hasanramaj ka paralajmëruar padi në Gjykatën e Strasburgut në rast se edhe më tutje do t'u shkelet kjo e drejtë. "Jemi ankuar në MPMS, gjykatë dhe te Avokati i Popullit, por askush s'e dëgjoi zërin tonë. Kjo është në kundërshtim me të gjitha standardet evropiane dhe të drejtat e njeriut. Prandaj, ne do t'i drejtohemi edhe Gjykatës së Strasburgut nëse institucionet tona vazhdojnë të luajnë me ne. Ky nen jo vetëm se është në kundërshtim me standardet dhe praktikat evropiane, por edhe i zhvlerëson diplomat dhe punën e Universitetit të Prishtinës pas vitit 1991. Me anë të këtij paragrafi na është mohuar e drejta e marrjes së pensionit me kualifikim të lartë shkollor dhe na kthyen në kategorinë e pensionistëve me shkollë të mesme, me arsyetimin se s'jemi kontributdhënës. Me anë të këtij neni po shkelën në mënyrë drastike të drejtat njerëzore të shtresave më të goditura të pensionistëve në kohën e pasluftës në Kosovë. Ne kemi dhënë kontribut për 46 vjet", ka deklaruar Hasanramaj.

Edhe pensionisti tjetër Syhejl Havolli, i cili është letrar, meqë ka të kryer Degën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe, ish-korrespondent i gazetës "Bota e re", ish-referent në Fakultetin e Filologjisë. Edhe ky është në mesin e mijëra pensionistëve që i mohohet njohja e diplomës së fakultetit. Në bazë të këtij neni edhe Havolli rangohet në mesin e personave me shkollim të mesme. "Unë kam qenë absolvent në vitin 1982, por mbrojtjen e diplomës e kam anashkaluar për shkaqe objektive, meqë kam qenë në marrëdhënie pune dhe jam marrë me shkrime letrare, kurse më në fund diplomova pas datës 1. 1. 1991 (më 18. VII. 1991), gjë që për gjashtë muaj e disa ditë nuk po e fitoj të drejtën e pensionimit me fakultet. Diplomën e kam mbrojtur te profesori eminent, prof. dr. Latif Berisha (tani i ndjerë). Tani kur më erdhi koha e pensionimit dhe shkova të lajmërohem, më thanë se unë s'kam të drejtë ta marr shumën e pensionit prej 230 eurosh, siç është për pensionistët me fakultet, por vetëm 172 euro. Unë personalisht nuk e kam hallin që po më mohohen 60 euro, por kjo nuk është e drejtë që shteti i Kosovës të na mohojë fakultetin të cilin e kemi përfunduar. Edhe unë i bashkohem thirrjes së pensionistëve të tjerë të diplomuar që këtë çështje do ta dërgojmë deri në Strasburg në qoftë se këta, për shkak të kalkulimeve të veta buxhetore, na trajtojnë në këtë mënyrë", ka thënë Havolli për gazetën "Epoka e re".

Në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), në një përgjigje me shkrim për gazetën "Epoka e re", është thënë se kategorizimi i pensioneve kontributpagues është i përcaktuar me UA 09/2015 dhe është në zbatim.

Kjo ministri ka bërë me dije se është në fazën e hartimit të koncept-dokumentit për reformën pensionale që i paraprinë Ligjit për Pensione dhe Beneficione dhe, sipas përgjigjes së MPMS-së, planifikojnë ta trajtojnë edhe këtë çështje. "Kategorizimi i pensioneve kontributpagues është i përcaktuar me UA 09/2015 dhe është në zbatim, ndërsa sa i përket numrit eventual të të diplomuarve pas 1. 1. 1991 që kanë të drejtë në pensionin kontributiv, MPMS nuk ka shënime. Mirëpo, në reformën pensionale që MPMS e ka ndërmarrë, ku tashmë jemi në fazën e hartimit të Koncept Dokumentit për Reformën Pensionale i cili i paraprinë Ligjit për Pensione dhe Beneficione, planifikojmë ta trajtojmë edhe këtë çështje", është

# qindra pensione kontributpagues



deri më tani kanë marrë vetëm premtime.
Kajtazi e ka akuzuar zyrën ligjore të Qeverisë. "Më vjen keq që në Zyrën Ligjore të MPMS-së dhe te kryeministrit nuk po i lexojnë siç duhet ligjet. Na është bërë padrejtësi dhe s'do të ndalemi derisa të njihet e drejta jonë e shkollimit siç e kemi. Ne kemi profile të ndryshme që përballen me këtë padrejtësi, duke filluar nga profesorë, doktorë, ish-zyrtarë të profileve të ndryshme të cilët kanë diplomuar pas vitit '91 e që s'u njihet diploma, por veç Shkolla e Mesme. Janë me qindra pensionistë të cilëve u është bërë kjo e padrejtë dhe, po ashtu, ka shumë të tjerë që s'kanë mundur të vijnë të ankohen për shkak të gjendjes shëndetësore", ka thënë Kajtazi
Më tutje, kryetari i Pensionistëve dhe Invalidëve, Dega në Prishtinë, Shaip Vitia, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kanë kërkuar disa herë nga MPMS-ja që kjo çështje të ndryshohet. Sipas tij, është numër i madh i pensionistëve të cilëve u është mohuar kjo e drejtë. "Është numër i madh i pensionistëve të cilët privohen nga kjo e drejtë. Është një Ramush Bllaca, drejtor në 'Emin Durak' për tetë vjet, kurse për pension nuk ia njohin diplomën pasi ka diplomuar pas '90-s. Ky është mëkat. Kjo është shkelje e të drejtave të njeriut. Prej kohësh na thonë se janë duke punuar, por ne po privohemi ta marrim pensionin në bazë të kontributeve që kemi dhënë", ka thënë Vitia.
Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, Rrahman Jasharaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se duhet të amandamentohet ligji dhe mos t'u mohohet e drejta e marrjes së pensionit në bazë të kontributit që kanë dhënë pensionistët, por t'u njihen diplomat që ata kanë. "Është problematike pasi dikur pensioni ka qenë unik për të gjithë, 148, pastaj me një ngritje që është bërë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka filluar t'i klasifikojë mësimdhënësit në bazë të titullit, shkolla e mesme, shkolla e lartë dhe fakulteti. Ne kemi bërë vërejtjet tona pasi është evidente që ata që kanë diplomuar pas vitit 1991 nuk u numërohet diploma e fundit, por diploma paraprake. Ne shpjegimin që e kemi marrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale na është thënë se janë nisur në kriterin që i ka më shumë me një diplomë nëse i kam 40 vjet punë, por 30 me shkollë të lartë, atëherë ata kështu janë nisur. Natyrisht, kjo nuk është e drejtë pasi duhet të shikohet diploma e fundit. Ne kemi kërkuar angazhime edhe nga MAShT-i. Është duke u amandamentuar ligji dhe do të shikojmë se të gjithë të punësuarit janë dëmtuar", ka deklaruar Jasharaj.
Jeton Demi, zyrtar për informim në Trustin Pensional, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në vitin 2017 vlera e kontributeve të reja ishte 159,757,519 euro. "Me 31. 12. 2015 në Trustin Pensonial të Kosovës ishin 297 466 kontribuues aktivë, në 2016 ishin 312 672 kontribuues, kurse me 31. 12. 2017 ishin 352 849 kontribuues aktiv. Kurse vlera e kontributeve të reja në 2015-n ishte 137 519 615 euro, me 31. 12. 2016 ishte 151 503 736 euro, ndërkaq më 31. 12. 2017 ishte 159 757 519 euro. Të pensionuar në vitin 2015 kemi 4 438 pensionistë, në 2016-n 4 445 pensionistë, kurse në 2017-n 5 173 pensionistë. Kurse vlera e shumës së paguar për vitin 2015 ishte 19 299 443 euro, në vitin 2016 ishte 19 208 575 euro, kurse në vitin 2017-n 27 739 647 euro. Ndërkaq rreth 10 milionë euro janë të kthyera në ATK si mjete të paidentifikuara, sipas legjislacionit në fuqi", ka thënë Demi.




thënë në përgjigjën e MPMS-së.
Ndërkaq deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, i cili është kryetar i Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, ka thënë për gazën "Epoka e re" se askujt nuk do të duhej t'i mohohet e drejta e marrjes së pensionit në bazë të kontributeve që ka dhënë. Sipas tij, do të duhej të bëhet amendamentimi i këtij ligji. "Duhet të amendamentohet ligji dhe secilit individ duhet t'i njihet kualifikimi nga dita kur ai është kualifikuar dhe, si i tillë, duhet të trajtohet dhe të paguhet ashtu si i takon. Askujt të mos i hyhet në hak, por të marrin pension si kolegët e tyre. Nëse e ka kualifikimin nga viti 1991 atëherë pagesa duhet të bëhet në bazë të vitit 91, nëse është nga viti 1994 duhet të fillojë nga ai vit", ka thënë Kurteshi.

Kryetari i Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës, Shaban Kajtazi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se janë qindra pensionistë të cilëve u janë shkelur të drejtat e njeriut me anë të këtij neni. Ai ka thënë se ka diskutuar edhe me kryeministrin Ramush Haradinaj për këtë çështje, por

## MPMS-ja, marrëveshje për aftësim profesional

**Prishtinë, 23 shtator** - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e aftësimit dhe riaftësimit profesional.
Marrëveshja që u nënshkrua në mes të ministrit të MPMS-së, Skender Reçica dhe drejtorit të KPK-së, Astrit Panxha, ka për qëllim bashkëpunimin në fushën e aftësimit dhe riaftësimit profesional, për përgatitjen profesionale të kuadrove në sektorin e prodhimit dhe nevojave të klubit të prodhuesve.
Ministri Reçica dhe drejtori Panxha e vlerësuan të rëndësishëm bashkëpunimin nëpërmjet kësaj marrëveshje, duke marrë parasysh nevojat e tregut të punës dhe kompanive të Kosovës, për ngritje të kuadrove në aftësim dhe riaftësim profesional dhe me qëllim të punësimit.
Të dy u pajtuan për thellim të bashkëpunimit edhe nëpërmjet projekteve të tjera në të ardhmen, që kanë për qëllim avancimin e përgatitjes profesionale të kuadrove në përputhje me nevojat e prodhuesve vendorë.



# Ish-luftëtari më i vjetër i UÇK-së në listat e veteranëve 'mashtrues'


TRUPAT E MBROJTJES SË KOSOVËS
SHTABI I PËRGJITHSHËM
Departamenti për Mardhënie Ushtarako-Civile
Nr. prot. 15/908, më 20-05.2008
PRISHTINË

Në bazë të Rregullores së Jetës së Brëndshme të TMK-së dhe sipas kërkesës përsonale nga **HASAN TAHIRI**, dhe në bazë të dokumentacionit që posedojmë, të **Listes së ushtarëve te Brig. 113 te Z.O. Drenices**, lëshojmë këtë:

VËRTETIM
PËR SHËRBIM NË USHTRINË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

| | |
|---|---|
| Emri, emri i babës, mbiemri | HASAN RRUSTEM TAHIRI |
| Data e lindjes | 20.10.1933 |
| Vëndi i lindjes, Komuna | PLLUZHINË,SKENDERAJ |
| Vëndbanimi, Komuna | PLLUZHINË,SKENDERAJ |
| Koha e shërbimit në UÇK | 28.03.1998 deri më 19.09.1999 |
| Funksioni | USHTAR |
| Njësia | BRIGADA 113"MUJË KRASNIQI" |

*Ky vërtetim shërben si dëshmi, se ka qenë pjesëtar/e i/e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa për nevoja tjera është i pavleshëm*

dedikohet:
- Personit
- Arkivit

SHEFI I DEPARTAMENTIT
Nënkolonel
AVDI RACI





SKENDERAJ, 23 SHTATOR (ER) - Publikimi i listave të veteranëve mashtrues ka sjellë shumë telashe e habi te veteranët e vërtetë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në këto lista po figurojnë edhe emrat e ushtarëve që kanë qenë pjesë e UÇK-së dhe janë veteranë. Ndër ta është edhe baca Hasan Bajraktari nga Plluzhina e Skenderajt, i cili është ndër veteranët me të vjetër që kanë mbetur gjallë.

Nipi i tij, Labinot Tahiri, është habitur se si gjyshi i tij, edhe pse 85-vjeçar, po konsiderohet si i rrejshëm, edhe pse ai dhe familjarë të tij ishin pjesë e Ushtrisë Çlirimtare para 20 vjetësh. Labinoti, edhe pse i ri në moshë, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se kanë kaluar 20 vjet nga lufta e Kosovës dhe tanimë është krijuar luftë kundrejt të vërtetës. "Përpjekjet e pareshtura të popullit shqiptar për ta fituar lirinë ishin të ndryshme varësisht nga koha dhe rrethanat, kjo kulmoi me luftën e fundit në Kosovë me ushtarët e UÇK-së. Gjatë kësaj periudhe edhe familjarët e mi ishin pjesëmarrës në krye me gjyshin tim Hasan Bajraktari. Kanë kaluar 20 vjet nga lufta e Kosovës dhe tanimë është krijuar luftë kundrejt të vërtetës, të vërtetës për çlirimtarët tanë, duke krijuar lista 'me veteranë të rrejshëm' e që pjesë e tyre ishte edhe gjyshi im. Nuk kam fjalë, vetëm do të them se kjo nuk do të lihet me kaq. Do të luftojmë prapë deri në fund për të sjellë në pah ata që me të vërtetë e meritojnë të kenë titullin veteranë. Hasan Bajraktari (që këta prokurorë apo kjo drejtësi e quajnë jo veteran) ka qenë në Lëvizje Kombëtare qysh në kohët e hershme, lëvizje kjo që rezultoi me formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe që nga fillimi e deri në mbarim të luftës sonë për liri ka qenë pjesë e UÇK-së", ka shkruar ai.

Sipas Labinot Tahirit, vlerat e luftës për liri dhe vlerat e tyre familjare nuk do të mund dhe nuk do të lejojnë që askush të shkelë mbi to. "Të gjithë ata që mundohen të manipulojnë me këto vlera nuk do të rrimë duarkryq dhe do të shkojmë deri në fund. Njëkohësisht ne si familjarë duam t'i falënderojmë të gjithë ata shokë dhe miq duke filluar nga kryetari i OVL-së, z. Hysni Gucati, e shumë njerëz të sferave të ndryshme, për mbështetjen, thirrjet dhe mesazhet e shumta", ka shkruar Tahiri.

# Zgjedhen organet drejtuese të Këshillit Profesional Shëndetësor në Ferizaj

FERIZAJ, 23 SHTATOR (ER) - Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Besnik Berisha, ka mbajtur një takim me anëtarët e Këshillit Profesional Shëndetësor në nivel lokal, mekanizëm ky konsultativ i themeluar muaj më parë. Në këtë mbledhje janë zgjedhur organet drejtuese të këtij këshilli me kryetar dr. Agim Bytyçi dhe nënkryetarë: dr. Sylejman Metushi dhe dr. Drita Lumi-Demiri.



Anëtarë të këtij këshilli janë emra të njohur të shëndetësisë së Ferizajt, si: drejtori i Spitalit të Ferizajt, drejtori i QKMF-së në Ferizaj, dr. Sylejman Metushi, dr. Agim Bytyçi, dr. Xheladin Reçica, dr. Abaz Beqa, dr. Shyqeri Hyseni, dr. Albert Sherifi, dr. Afrim Abazi, dr. Hesat Shatrolli, dr. Mufail Hasani, dr. Sylejman Topalli, dr. Ramadan Çerkini, dr. Nehat Halili, dr. Drita Lumi-Demiri, dr. Xhevdet Haxhidema, dr. Fatbardh Ramadani, dr. Afrim Rexhepi, dr. Ylber Murati dhe dr. Ardiana Ndoja, të cilët angazhimin e tyre në kuadër të këtij mekanizmi do ta realizojnë përmes ekspertizës profesionale në dobi të përmirësimit më të madh të shërbimeve shëndetësore dhe paraqitjes së nevojave që ka ky sektor në nivel lokal. Mjekëve të pranishëm në këtë takim u është prezantuar edhe projekti i ndërtimit të Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj, i cili përfundimisht përmbush nevojën për hapësira dhe kushte më të mira në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në nivel lokal.



# Zbulohet busti i Gjergj Kastriotit në Stubëll të Vitisë

VITI, 23 SHTATOR (ER) - Zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Gjergj Dedaj, ka marrë pjesë në zbulimin e bustit të Gjergj Kastriotit Skënderbeut në Stubëll të Komunës së Vitisë. "Kisha nderin dhe privilegjin që së bashku me At Antonio Bellushin nga Kalabria, Ipeshkvin e Kosovës, monsinjor Dodë Gjergji dhe veprimtarin nga Maqedonia, Muzafer Bislimi, ta zbulojmë bustin e heroit legjendar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu në Stubëll të Vitisë!", ka shkruar Dedaj në llogarinë e vet në "Facebook".

## Vritet një person në Deçan

Deçan, 23 shtator - Në Komunën e Deçanit të dielën është vrarë një person. Lajmin e ka konfirmuar zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e Pejës, Driton Rugova. "Rreth orës 11:10 policia është njoftuar se në rrugën 'Luan Haradinaj' në Deçan ka ndodhur një plagosje me armë zjarri. Policia menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes. Viktima A. T. (1989) fillimisht është dërguar në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Deçan, por si pasojë e plagëve të rënda është dërguar në Spitalin Rajonal në Pejë ku, sipas ekipit mjekësor, viktima ka arritur pa shenja jete në këtë spital", ka thënë Rugova.

Policia ka njoftuar se personi i dyshuar me inicialet Sh. G. (2000) është arrestuar dhe me vendim të prokurorit të shtetit është dërguar në ndalim policor prej 48 orësh, për të vazhduar me procedura të tjera ligjore. Ndërkaq trupi i pajetë i viktimës, me urdhër të prokurorit do të dërgohet në Institutin e Mjekësisë Ligjore për obduksion.

# Përse heroi im është Fehmi Lladrovci



Bedri ISLAMI

Më 22 shtator u bënë 20 vjet që nga rënia në luftë e dy figurave ndër më të shquara të shekullit të shkuar, në të gjithë hapësirat shqiptare: Fehmi Lladrovci dhe bashkëshortja e bashkëluftëtarja e tij, Xhevë Krasniqi Lladrovci.

Për jetën dhe luftën e tyre unë kam shkruar shumë herë, gjithnjë me ndjenjën që më ka shoqëruar, se për ta asnjëherë nuk mund të thuhet e vërteta e plotë, në të gjithë dimensionet dhe, megjithëse libri "Përjetësia e dyfishtë" zgjoi jo vetëm kureshtjen, por edhe diskutime drejt së mbarës, përsëri e veçanta e një Njeriu që bëri aq shumë, është përtej dimensioneve.

Disa ditë më parë, lidhur me staturën e një figure të politikës, unë shkrova se ai nuk është heroi im. Por, në jetë, kushdo e ka një hero, drejt të cilit përpiqet të shkojë dhe të ndiejë se përmes tij mund të ketë një jetë ndryshe, ndoshta më të vështirë, por edhe më të bukur, më të plotë dhe, natyrisht, më të kuptueshme.

Përse është pikërisht një drenicas heroi im, njeriu i cili rrënjësisht ka ndryshuar jetët e qindra të tjerëve dhe ka ngjallur idenë se "duke qëndruar me të është njëlloj si të rrish me vetveten". Dhe përse, në pragun e luftës në Kosovë, shumë ushtarakë të lartë shqiptarë në Kroaci e Bosnje, nën thirrjen e tij iu bashkuan UÇK-së dhe deklaronin haptas se, "sikur Zoti t'i kishte dhënë 10 Fehmi Lladrovcë Kosovës, ajo kishte me qenë qyshkur e lirë".

Përse një prijës legjendar, Adem Jashari, thoshte se "vetëm vdekja më ndan nga Fehmi Lladrovci", e nga ana tjetër Adem Demaçi ishte i bindur se "nëse këtë e ka thënë Fehmiu, është punë e kryer"?

Përse ishte ky besim ndaj tij, deri në verbëri? Përse pas 5 marsit 1998, pas rënies së Adem Jasharit, vajtja e tij në Kosovë, bashkë me një grup të madh që ishin e u bënë drejtuesit e luftës, ngjalli aq shumë besim dhe mijëra veta u bashkuan me të apo shkuan pas tij?

Kur unë e kam takuar për herë të parë, lufta ende nuk kishte filluar. Ajo që më bëri përshtypje në momentin e parë ishte shtati i tij i gjatë, mbi 1 metër e 90 cm, qëndrimi i drejtë, trupi i dukej sikur nuk përkulej dhe, mbi të gjitha, sytë e tij. Dukeshin sikur në një palë të vetëm ishin dhjetëra sy, të cilët asnjëherë nuk e fshihnin të vërtetën.

Unë shkoja tek ai nga mjediset e gazetës. Ai sapo kishte ardhur nga lufta në Kroaci. Atje ish-studenti i Inxhinierisë dhe një ndër studentët më të shkëlqyer të tij kishte formuar brigadën e parë luftarake të shqiptarëve të Kosovës dhe kishte zhvilluar njërën nga betejat më të ashpra, të njohur si lufta për Gospiqin, duke e marrë qytetin pa asnjë të vrarë nga ana e luftëtarëve shqiptarë dhe duke u kthyer dinjitetin e humbur vendësve që prisnin nën thikën e ankthit çetnikët serbë.

Në kohën kur unë kisha qenë student, ai kishte qenë në fillimet e të qenurit pjesë e lëvizjes klandestine çlirimtare. Me disa nga figurat më të njohura të kohës, si Nuhi Berisha, Rexhep Mala, Shaban Shala, sot heronj të Kosovës, liderin Ali Ahmeti, kishin formuar një parti të veçantë: Partinë e Luftës dhe ai do të ishte një ndër organizatorët e parë. Do të ishte pagëzimi i parë i tij, por edhe një fillesë, e cila do të zgjaste 25 vjet nëpër të gjitha trevat, duke formësuar një staturë të jashtëzakonshme politike dhe një rreth të jashtëzakonshëm bashkëluftëtarësh, të cilët, natyrshëm, e njihnin atë si prijës dhe komandant.

Në mesin e vitit 1986 do të bëhet bashkimi i të gjithë grupeve klandestine që vepronin në Kosovë, një proces që njihet si bashkimshkrirja dhe zgjidhet sekretariati politik, ku një prej anëtarëve, i caktuar për problemet e mbrojtjes, do të jetë Fehmiu.

Arrestohet dhe dënohet me 10 vjet. Në gjyq do të pranojë se është irredentist e nacionalist dhe se i qëndron idesë se Kosova duhet të jetë republikë e pavarur dhe se i takon e drejta e bashkimit me shtetin amë.

Sapo është fejuar. Xheva, e diplomuar dy herë, për gjuhë e letërsi shqipe dhe jurisprundencë është, po ashtu, nga një familje, e cila ka kaluar nëpër burgjet politike të shtetit serb. Çfarë do të ndodhë me jetën e tyre: njëri në burg dhe tjetra e sapopërjashtuar nga arsimi, pasi ishte lidhur me një nacionalist?

Takohen në burg. Ajo sapo i kishte shkruar se "tani që pashë qëndrimin tënd në burg, jam e dashuruar edhe më shumë me ty", por ai mendon se dhjetë vjet janë shumë, vajza mund të ketë një jetë më të qetë, por ata janë lidhur fillimisht nga përkushtimi e më pas nga ajo ndjenjë që do i bashkonte deri në çastin e fundit të jetës. Ai i thotë se koha është të mendohet edhe një herë, ata mbesin shokë të idealit deri në fund, por jetët mund t'i kenë ndryshe". Është i vetmi çast kur ajo zemërohet me të, jetën e kanë të përbashkët. Dita e dasmës është caktuar, dhëndëri është në burg. Në të njëjtën qeli me Adem Demaçin. Demaçi ia vendos emrin "zharavë", zjarr. Në ditën e dasmës, nusja e veshur me kostumin kuq e zi merr rrugën drejt Drenicës, tek shtëpia e Fehmiut dhe, për shumë vite, derisa ai lirohet para kohe, pasi ndodhej në një burg kroat, ata janë pranë dhe larg.

Fillon kështu një korpus i jashtëzakonshëm letrash mes tyre. Një ndjenjë pasionante, edhe dashuria mes njerëzve por, mbi të gjitha, dashuri për njerëzit. Të dy e shkruajnë shkëlqyeshëm gjuhën letrare shqipe, njohin të gjithë ata çfarë ka botuar Agolli, Kadare, Xoxa, Arapi, njohin studimet e Aleks Budës dhe të Çabejt, njëlloj si do t'i njohin më pas armët. Rrallëherë kam lexuar një korpus të tillë letrash. Një botë e pamatë hapet përmes tyre. Të gjithë të burgosurit e quajnë motër. Në çdo letër ajo u shkruan edhe të burgosurve të tjerë politikë; ai i tregon se çfarë bëjnë, si rrjedh jeta në kazamatet serbe, çfarë i bashkon këta njerëz që e ndiejnë festën e vitit të ri atje në burg shumë më tepër se ata që rrinë në lokalet e natës së Prishtinës.

Unë e kam parë këtë njeri, më saktë, këta dy njerëz, në shumë momente të veçanta e herë-herë të rënda, në jetën e tyre. Fehmiun edhe mund ta kundërshtoje e të mos ishe i të njëjtit mendim me të, por nuk mund të zemëroheshe. E dija se ai ishte, si do e përcaktonte saktësisht profesor Rexhep Qosja, "idealisti më idealist". Kishte vizionin e së ardhmes njëjtë me të shkuarën e domosdoshme për të bërë një luftë. "Lufta guerile, thoshte, ishte ajo që nis me synimin për të përmbysur një mbretëri, por përfundon në kaçakllëk, nëse nuk shtrihet e nuk bëhet e të gjithëve.

Niset për në Kosovë në majin e vitit 1997. Dhjetë veta vihen në udhë. Do të jenë ndër emrat më të njohur të lëvizjes çlirimtare. Fehmiu, Xheva, Ilaz Kodra, Luan Haradinaj, Ramush Haradinaj, Selim Krasniqi, Gani e Rafet Rama, Abedin Rexha dhe Ramiz Lladrovci. Pesë prej tyre, më pas, do të jenë heronj të Kosovës. Tetë nga ata do të kenë më pas gradën e gjeneralit. Xheva do të jetë gjeneralmajor e parë e ushtrisë shqiptare. Kishte luftuar në Kroaci, po luftonte në Kosovë.

Ramizi, vëllai i tij, ambasadori më i suksesshëm i Kosovës në Shqipëri, më tregonte se kur Fehmiu, i vëllai i besoi detyrën e parë, i dha edhe këshillën se, "nëse tradhton shokët, mos e prit nga askush tjetër, unë vetë ta jap hakun". Dhe kishte shtuar, "megjithëse jam i sigurt se kurrë nuk ligështohesh".

Përse ai u bë heroi im?

Gjithë jeta e tij ka qenë ajo e ndershmërisë njerëzore. Çdo gjë që bënte e merrte shumë seriozisht. Edhe shkollimin, edhe lëvizjen klandestine, edhe luftën, edhe fjalën, edhe miqësinë. Njeriu që kurrë nuk e ndërronte fjalën që kishte thënë e që kurrë nuk kishte bërë një gjë të pahijshme. Ulur në postiqen e tij, duke pirë çaj, nuk e kam parë asnjëherë duke pirë alkool, duke thithur cigaren, ai ta afronte pamjen e njeriut që të falte besim, të bëheshe të ndiheshe se je një tjetër, dhe të mos e lodhje mendjen për gjërat që mund të rëndonin.

Pastaj erdhi 22 shtatori i 20 vjetëve më parë. Disa ditë më herët u kishte thënë shokëve se së shpejti armata serbe do ta sulmonte Drenicën. Komandanti i brigadës 114 ishte njeriu i të dhënës së sigurt. Ishte edhe njeriu që serbët e kërkonin ngado. Ishin vënë shuma të mëdha për kokën e tij.

Një ditë e një natë qëndroi në atë që sot quhet "Kodra e Qëndresës". Pranë tij u vra një vajzë e re, Fatime Hetemi, për të cilën thoshin se është vajza jonë, ngaqë nuk kishin fëmijë, më pas një student prishtinali, dhe gjithçka rreth e rrotull tyre ishte e frikshme, por ata nuk e ndjenin frikën. As nuk mund të linin trupat e të dy rinjve në llogore. Gjashtë orë në pozicionin e tij, me një pushkë snajper. Tri tanke serbe kishin qëndruar rreth 100 metër më tej dhe heshtnin. Fehmiu i dha një shokut të tij, ta zëvendësonte pak sa të pinte një cigare. U mbështet me shpatullat pas kodrës dhe aty, nga tanku i parë, një pushkë snajper, e qëlloi në ballë. Ra ngadalë dhe tha vetëm "Shotë, më qëlluan".

Komandën e mori Xheva. Largoi të tjerët nga rrethimi dhe u premtoi se do të vinte pas tyre. Ishte hera e parë dhe e fundit që nuk e mbajti fjalën. Vazhdoi të qëllonte. E vetme në atë llogore që do të bëhej vend historik. Më pas, e ndjeu goditjen. Shkoi deri ku ishte trupi i Fehmiut dhe mbështeti kokën në kraharorin e tij. Tanket qëlluan kodrën dhe dherat e shumtë i mbuluan.

Aty i gjetën pas dy ditësh, mbështetur tek njëri-tjetri.

Të gjithë e kishim ditur se, nëse do të vritej njëri prej tyre, tjetri nuk do të mund të jetonte.

Jorastësisht, në qershorin e vitit 1987, në njërën nga letrat e saj, Xheva i kishte shkruar, "edhe jetën, edhe vdekjen, i kemi së bashku".

Një profeci që do të bëhej e prekshme 11 vjet më pas.

Të gjithë mediat serbe shkrumbuan se e vranë rebelin, ish-luftëtarin, njeriun që u kishte nxjerrë aq shumë probleme.

Në Kroaci qeveria shpalli ditë zie kombëtare.

Në librin tim "Përjetësia e dyfishtë" kam shkruar: "Ata kishin mbetur aty, bri njëri-tjetrit, dhe kjo kishte qenë zgjedhja e tyre. Nuk kishin dashur fat tjetër dhe nuk kishin kërkuar asnjëherë fat tjetër. Fijet e barit lëviznin së bashku me erën dhe të dukej sikur ishte lamtumira e fundit. Asaj i kishte mbetur njëra dorë pranë zemrës së tjetrit, sikur të kishte dashur t'ia dëgjonte rrahjet deri në fund".

Ja, krejt shkurt, pse ky njeri është heroi im.

Dy ditë më parë, në Drenicë, u vendosën shtatoret e tyre. Më takoi ta mbaja fjalën e rastit. Për një rastësi që nuk do e kisha dashur kurrë, edhe kur ishin vrarë 20 vjet më parë, në atë pozicion që kisha pasur, më kishte takuar të flas e betohem në ditë përkujtimin e tyre.



## Departamenti i Sigurisë Kombëtare, me propozim të ri për ndihmat e imigrantëve

UASHINGTON, 23 SHTATOR - Departamenti i Sigurisë Kombëtare ka bërë të njohur një propozim për personat që hyjnë dhe synojnë të qëndrojnë në Shtetet e Bashkuara: që ata të mos kenë përfitime publike, siç janë programet e ndihmave për ushqime, ilaçe me recetën e mjekut, ose strehim.
Ky propozim u bë i njohur përmes një deklarate të publikuar në internet të sekretareshës së Sigurisë Kombëtare, Kirstjen Nielsen, në pritje të komenteve të publikut, në mënyrë që rregulli i propozuar të jetë transparent. "Rregulli i propozuar do të zbatojë një ligj të miratuar nga Kongresi, që synon promovimin e pavarësisë dhe vetëbesimit të imigrantëve, si dhe ruajtjen e disa burimeve, në mënyrë që imigrantët të mos bëhen barrë për taksapaguesit amerikanë", thuhet në deklaratë.
Në deklaratë thuhet se Departamenti i Sigurisë Kombëtare do t'i shqyrtojë "përfitimet e tanishme dhe ato në të shkuarën mbi një prag të caktuar, si një faktor tepër negativ" për personat që i marrin këto ndihma.
Në përfitimet publike hyjnë ndihmat shtetërore, ose federale, si kuponë për blerjen e ushqimeve, disa lloje të sigurimeve shëndetësore, qëndrimi në institucione të caktuara për një periudhë të gjatë kohe me shpenzimet e qeverisë dhe ndihmat për strehimin.



Ky propozim do të publikohet zyrtarisht në Regjistrin Federal në javët e ardhshme dhe publikut do t'i lihen 60 ditë për t'i shprehur komentet e tyre me internet, ose me e-mail.

# Nis ndërtimi i murit ShBA - Meksikë

Për gjashtë nga 3 200 kilometra të kufirit, seksioni i ri do ta zëvendësojë gardhin ekzistues përgjatë vijës ndërmjet El Pasos, Teksasit dhe Ciudad Juarezit në Meksikë. Këtë mur e ka kërkuar presidenti Donald Trump për ta kundërshtuar imigracionin e paautorizuar që ai e konsideron një kërcënim për sigurinë




UASHINGTON, 23 SHTATOR - Fillon në ShBA ndërtimi i murit të ri në kufi me Meksikën, një mur i kërkuar nga presidenti Donald Trump, për ta kundërshtuar imigracionin e paautorizuar, që ai e konsideron një kërcënim për sigurinë. Për gjashtë nga 3 200 kilometra të kufirit seksioni i ri do ta zëvendësojë gardhin ekzistues përgjatë vijës ndërmjet El Pasos, Teksasit dhe Ciudad Juarezit në Meksikë.
Pjesa më e madhe e kufirit kufizohet tashmë nga gardhe dhe pengesa të tjera, por Trumpi ka urdhëruar një "pengesë të vazhdueshme fizike dhe jo të kalohet" që, sipas shkencëtarëve, do ta vë në rrezik ekzistencën e më shumë se një mijë specieve dhe kafshëve.
Kongresi deri më tani ka miratuar 1.6 miliard dollarë nga 25 miliardë që Trumpi ka kërkuar për ndërtimin e murit, i cili ishte një nga premtimet e tij të betejës në fushatën elektorale. Fillimisht, ai kishte kërkuar që Meksika t'i paguante shpenzimet, gjë që shtoi tensionin ndaj marrëdhënieve mes dy vendeve.
Presidenti i zgjedhur i Meksikës, Andres Manuel Lopez Obrador, tha se nuk ka ndërmend për ta kundërshtuar presidentin amerikan Donald Trump mbi emigracionin. "Ne nuk do të luftojmë me Qeverinë amerikane, nuk do të luftojmë me presidentin Donald Trump", tha ai. "Problemi i emigracionit nuk mund të zgjidhet duke ndërtuar mure ose duke përdorur forcën, por është një punë diplomatike mbi respektin reciprok", shtoi Lopez Obrador.
Administrata Trump ka njoftuar një shtrëngim në lëshimin e kartave të reja të gjelbra për emigrantët, të cilët ligjërisht përfitojnë nga përfitimet publike, si ndihma për ushqim ose kuponë për strehim. Raportet e "New York Times"-it shpjegojnë se goditja mund të prekë miliona njerëz që jetojnë në varfëri dhe se ata do ta gjejnë veten të detyruar të zgjedhin ndërmjet ushqimit dhe ndihmës për banim dhe marrjen e një kartoni të gjelbër.

# Erdogani shpreson t'i përmirësojë marrëdhëniet me Gjermaninë



ANKARA, 23 SHTATOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, thotë se shpreson se vizita e tij në Gjermani do të ndihmojë në dhënien fund të tensioneve në mes të dyja shteteve. Përmirësimi i marrëdhënieve mes qeverive të dy shteteve, bashkëpunimi ekonomik, aplikimi i Turqisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe lufta kundër terrorizmit do të jenë prioritetet që do të diskutohen gjatë vizitës në Gjermani, u tha të dielën gazetarëve presidenti turk, raporton Dpa.
Erdogani do të arrijë në Berlin të enjten me ftesë të homologut të tij gjerman, Frank-Walter Steinmeier. Ai pritet të takohet dy herë me kancelaren gjermane Angela Merkel përpara se të marrë pjesë në hapjen e një xhamie në Këln. Për muaj të tërë Turqia dhe Gjermania kanë tentuar t'i përmirësojnë marrëdhëniet të cilat u përkeqësuan pas arrestimit të shtetasve gjermanë në Turqi dhe shqetësimeve për shkeljet e të drejtave të njeriut nga Ankaraja.

## Rohani i fajëson shtetet e Gjirit Persik për sulmin gjatë paradës ushtarake

TEHERAN, 23 SHTATOR - Presidenti iranian Hassan Rohani ka fajësuar separatistët arabë për sulmin gjatë një parade ushtarake dhe ka akuzuar shtete të Gjirit Persik që mbështeten nga Shtetet e Bashkuara, që i mbështesin separatistët. Megjithatë, Rohani nuk ka dhënë detaje se për cilat shtete bëhet fjalë.
Komentet e Rohanit vijnë pasi Garda Revolucionare Islamike e Iranit është zotuar se do të hakmerret për sulmin e 23 shtatorit, ku u vranë 25 persona, përfshirë këtu 12 komandantë të kësaj garde.
Teherani po ashtu ka thirrur në takim diplomatët nga Danimarka, Holanda dhe Britania nën dyshimet se këto vende kanë pasur kontakte me anëtarët e grupit të dyshuar Rezistenca Kombëtare e Ahvazit - një grup arab që ka marrë përgjegjësinë e sulmit në Iran.
Grupi militant, Shteti Islamik, po ashtu ka marrë përgjegjësinë për këtë sulm. "Për ne është e qartë se kush e ka bërë këtë, cili grup është ai dhe me kë janë të lidhur", tha Rohani. Shtetet e Bashkuara dhe Kombet e Bashkuara kanë dënuar sulmin, i cili është një nga më vdekjeprurësit në republikën islamike në këto vitet e fundit.



(Me rastin e 80-vjetorit të lindjes)

# Emil Lafe dhe 'Fjalori enciklopedik shqiptar'

**Prof. dr. Emin KABASHI**
**Instituti Albanologjik i Prishtinës**
**Këshilltar shkencor**

### Përkufizimi

Një vepër e përmasës kombëtare, pra që mëton të japë në thellësi dhe në gjerësi, udhët e historisë së një kombi, doemos për të krijuar vlerë, kërkon angazhim të mirëfilltë të të gjithë të diturve të atij kombi, në kohën e dhënë dhe në hapësirën ku realizohet.

Mund të thuhet prandaj, "Fjalori enciklopedik shqiptar", në tri vëllime, marrë në përgjithësi, ka përmbushur këtë kërkesë, qoftë me përmbajtjen, qoftë me shtrirjen, qoftë me cilësinë e shqyrtimit. Bartëse e këtij projekti të madh kombëtar, ishte Qendra e Enciklopedisë shqiptare, siç quhej atëherë, e cila veprimtarinë e saj e zhvillonte në kuadër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Brenda kësaj bërthame shkencore, njeriu më meritor për përfundimin e një pune kaq të madhe dhe kaq të mundimshme, ishte dijetari dhe profesori i palodhshëm, Emil Lafe.

### Hyrje

"Fjalori enciklopedik shqiptar", ashtu siç e kanë shpjeguar edhe hartuesit e tij, për herë të parë përfshinte gjithë trashëgiminë kombëtare, pa marrë parasysh kufijtë ekzistues politikë, që edhe sot ndajnë kombin shqiptar.

Do të thotë, ishin krijuar kushte dhe rrethana të reja, sidomos pas rënies së Murit të Berlinit, sidomos pas zhbërje së perandorisë ideologjike komuniste të Bashkimit Sovjetik, sidomos pas luftës me përmasë kombëtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në këtë rrjedhë ishin krijuar rrethana të reja, ishin krijuar përbërës të rinj, edhe në planin e historisë kombëtare të shqiptarëve, gjë që kërkonte edhe qëndrim të ri, metodologjik dhe metodik, pragmatik dhe gjithëpërfshirës, kuptohet aq sa mund të arrihej përfshirja e të gjitha institucioneve shkencore dhe kulturore në hapësirën shqiptare, si dhe aq sa mund të përfshiheshin kuadro të gatshme për angazhim në realizimin e një projekti të këtillë kombëtar.

Në këtë veprimtari të gjerë dhe të çmueshme kishte edhe kurthe e prita, kishte edhe vënie kushtesh dhe shantazhime, kishte edhe cinizëm e mjerim intelektual, që doemos pengonte ecurinë normale të rrjedhës së kësaj veprimtarie të madhe kombëtare.

Sido që të jetë, sido që kanë rrjedhur punët, "Fjalori enciklopedik shqiptar" ka dalë më i plotë se asnjëherë tjetër, fjalori ka përfshirë thuajse gjithë vlerat kombëtare të popullit shqiptar, ka prekur dhe ka shqyrtuar edhe lashtësinë historike, edhe kohët e errëta të kësaj historie, por edhe majat e gjëllimit kombëtar, falë figurave të mëdha të kombit tonë.

### Enciklopedia shqiptare dhe akademitë e shkencave

E ka thënë edhe redaktori i "Fjalorit enciklopedik shqiptar", Prof. Emil Lafe, se fillimisht edhe Akademia e Shkencave në Tiranë, nuk e kishte fort të qartë metodologjinë e hartimit të "Fjalorit...".

Kurse Akademia e Shkencave dhe e Arteve në Prishtinë, jo vetëm që nuk ishte e gatshme për bashkëpunim, por vinte edhe kushte, edhe duke kërcënuar se do të zhbëhej Standardi i gjuhës shqipe, nëse redaksia e "Fjalorit..." nuk vepron sipas kushteve dhe kërkesave të tyre, thuajse Kosova i kishte pyetur ndonjëherë akademitë në shërbim të politikës së ditës, si dhe politikën, se cilin standard ta përdorte.

Këtu po citojmë vetëm një mendim të Prof. Emil Lafes, lidhur me bashkëpunimi e akademive të shqiptarëve në Tiranë dhe në Prishtinë, për të krijuar edhe një përfytyrim më real edhe për vështirësitë në rrugën e realizimit të këtij projekti të madh kombëtar.

"Akademia e Kosovës pati dërguar dikur disa propozime, që mund të quhen largvajtëse, dhe në fund paralajmëronte se, po të mos pranoheshin ato, në Kosovë do të shtoheshin zërat për një përmbysje të plotë të normës letrare, d.m.th. Kosova do të krijonte standardin e vet. Më ka ardhur keq për këtë lloj shantazhi". (Java, 7 korrik, 2012).

Më shumë se kaq, veprimet e disa akademikëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, shkonin aq larg sa ardhjet e hartuesve të zërave nga Tirana në Prishtinë, mbajtja e kontakteve dhe punët përgatitore, mësimi se si të hartohen zërat dhe si të shqyrtohen të dhënat e shumta që mund të kishte një shkrues, i quanin ardhje ilegale, kurse qëndrimin e tyre, qëndrim i fshehtë, një zot e di për cilat arsye dhe për ç'lloj të veprimtarisë.

Mirëpo, përkundër të gjitha këtyre pengesave, ndonjëherë edhe kërcënuese, Redaksia e "Fjalorit enciklopedik shqiptar" vazhdonte punën e saj, mbi të gjitha e, para së gjithash, falë angazhimit dhe punës madhore të Prof. Emil Lafes.

### Fjalori enciklopedik i shqiptarëve dhe gjuha e reklamës

Puna me "Fjalorin enciklopedik shqiptar" ka filluar thuajse që në vitet e para pas Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mirëpo, kishte periudha kohore, kur edhe udhëtimi, edhe komunikimi, edhe mungesa e kushteve elementare, kishte ndikuar në shtyrjen e kohës për përfundimin e punëve të caktuara.

Pas botimit të "Fjalorit enciklopedik shqiptar", në tri vëllime, mund të thuhet se në Kosovën e lirë, nuk është shkruar asnjë paraqitje publike, në asnjë gazetë apo revistë të vendit, mund të thuhet se as në televizion dhe në radio nuk kishte paraqitje të duhur por të mos thënë, se ishte bërë një lëçitje, si me kanun, kundër atyre që kishin dhënë ndihmesën e tyre në hartimin, redaktimin dhe botimin e "Fjalorit...".

Kjo është një dëshmi tjetër, thuajse e qëndrimit përbuzës ndaj vlerave të kulturës kombëtare, vetëm se nuk është punuar sipas kritereve që kishte përcaktuar Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Përkundër të gjithave, përkundër fjalamanisë dhe rrahagjokseve për atdhetarizëm, të të gjithëve në Prishtinë dhe në Tiranë, sepse thonë pas luftërave të gjithë bëhen atdhetarë, në Prishtinë duhej të shpikej një punë, e cila do ta dëshmonte këtë rrahagjoksi, andaj u krijuan grupe pune për hartimin edhe të historisë së Kosovës, edhe të Enciklopedisë së Kosovës, sado që nuk e di si do ta quajnë këtë të fundit, Enciklopedi shqiptare e Kosovës, apo pa atë ndajshtimin shqiptare, sepse së paku që nga themelimi e këndej, dihet qëndrimi i Akademisë në Prishtinë, se i mjafton vetvetja dhe kjo gjysmë që ia ka lënë pushtuesi i tokave shqiptare.




Prandaj, edhe përkundër të gjithave, "Fjalori enciklopedik shqiptar", ka përmbushur kërkesat themelore të një enciklopedie me përmasë kombëtare, siç u tha në përkufizimin në fillim të këtij shkrimi, qoftë për nga thellësia historike e trajtimit të ngjarjeve dhe personave me vlerë kombëtare, ose që janë bërë vlerë kombëtare me kalimin e kohës, qoftë për nga gjerësia e përfshirjes së hapësirës kombëtare, së paku atje ku jetojnë, veprojnë dhe krijojnë shqiptarët dhe gjuha e tyre.

Shtrirjen e këtyre vlera e ka përkufizuar qartë, redaktori i "Fjalorit enciklopedik shqiptar", me rastin e botimit, duke u shprehur se shqiptarëve u jepej një vepër e përmasë kombëtare. "Me këtë rast, shkruan Prof. Emil Lafe, shpreh bindjen time se hartuesit dhe përgatitësit e kësaj vepre i kanë dhënë popullit shqiptar, veçanërisht brezave të rinj, një dëshmi të qartë të pasurisë së vlerave tona historike e kulturore, një dëshmi të lashtësisë dhe të njësisë së fisit shqiptar, një dëshmi të mundësive për të ecur më shpejt përpara, një dëshmi dinjiteti njerëzor e kombëtar. Prandaj për vepra të tilla ia vlen të mendosh, të diskutosh, të punosh. Ato janë vepra që përfaqësojnë shkencën dhe kulturën kombëtare shqiptare, janë përgjegjësi e të gjithëve dhe nder i të gjithëve!". (Kumtesë me titull " 'Fjalori enciklopedik shqiptar' (2008-2009) si fryt dhe pasqyrues i shkencës shqiptare", mbajtur në Prishtinë, më 2 shtator 2011).

### Përfundim

Një vlerë e veçantë e "Fjalorit enciklopedik shqiptar" botuar në tri vëllime, përveç të tjerash, edhe se përherë të parë, në një botim shkencor Lufta e Ushtrisë Çlirimtare trajtohet e barabartë me luftërat e tjera çlirimtare, trajtohet si vlerë me përmasë kombëtare, si dhe shqyrtohet dhe analizohet pa e kthyer kokën anash se a mos dikush nga diku na akuzonte për kombëtarizim të njëanshëm.

Në këtë plan, ka ndihmuar shumë, edhe kryetari i redaksisë së Historisë dhe të Ushtrisë, prof. Dr. Ruzhdi Ramadani. Por, pa mbështetjen, pa përkrahjen dhe pa këmbënguljen e redaktorit të "Fjalorit...", Prof. Emil Lafe, zor se edhe kjo pjesë e punëve do të ishte kryer me sukses.

Në mbyllje të kësaj fjale, do të shtoja diçka me interes, qoftë për ata që punë të caktuara kryejnë nëpër arkiva, qoftë për ata që merren me fushën e kulturologjisë, lidhur me angazhimin e Institutit Albanologjik të Prishtinës, ndoshta si institucioni i vetëm shkencor në Kosovës, që ka mbështetur dhe ka punuar për përfundimin me sukses të "Fjalorit enciklopedik shqiptar".

Këtu as nuk po thurim lavde, as nuk po bëjmë elozhe, siç do të thoshin francezët e mençur, por vetëm prekem një të vërtetë që heshtet zakonisht në Prishtinë, e harrohet ndonjëherë në Tiranë.

Më tutje, për ata që kanë interes për të parë ecurinë, rrjedhën dhe përfundimin e punës në një projekt të madhe kombëtar, siç është "Fjalori enciklopedik shqiptar", është shumë i rëndësishëm letërkëmbim që është mbajtur në mes Prishtinës dhe Tiranës, në mes hartuesve të zërave dhe redaksisë së "Fjalorit...", në mes kryetarëve të redaksive të "Fjalorit..." dhe personave që ishin ngarkuar me hartimin e zërave nga fusha të ndryshme që mbulonte veprimtaria për botimin e "Fjalorit...".

Një letërkëmbim që ka zgjatur me vite, përmes të cilit shpalohen jo vetëm dilemat dhe mëdyshjet, jo vetëm paqartësitë dhe pakënaqësitë, jo vetëm pengesat dhe kurthet, jo vetëm mendjemadhësia shterpe dhe euforia e dijes pa argumente, por edhe këmbëngulja që gjerat të punohen mirë, që zërat të hartohen sipas standardeve enciklopedike, si dhe të ruhet me çdo kusht baza argumentues dhe qartësia gjuhësore e mendimit.

Të gjitha këto janë shpërfaqur edhe në letërkëmbimin me redaktorin e "Fjalorit enciklopedik shqiptar", prof. Emil Lafen, pa angazhimin dhe punën e palodhshme të tij, dyshoj se ky projekt i madh kombëtar do të ishte përfunduar në këtë nivel dhe me këtë cilësi.

**Prishtinë, më 21. 9. 2018**

---

**PROGRAMI**

21 shtator 2018, e premte
Ora 11.00 Hapja e Konferencës

**Seancën e drejtojnë**: Qemal Murati, Shefkije Islamaj, Rami Memushaj, Hysen Matoshi

**Qemal MURATI:** Fjala e hapjes së Konferencës shkencore

**Hysen MATOSHI:** Fjalë përshëndetëse

**Shefkije ISLAMAJ:** *Xhevat Lloshi dhe Emil Lafe - përkushtim jetësor ndaj gjuhës dhe gjuhësisë*

**Xhevat LLOSHI**: *Fjalorët dygjuhësh të shqipes me turqishten*

**Emil LAFE**: *Fjalori rusisht shqip i Institutit të Shkencave (1954) si dëshmi e shqipes letrare të kohës*

**Rami MEMUSHAJ:** *Xhevat Lloshi për kriteret e vlerësimit të huazimeve*

**Viktor RISTANI:** *Strategjitë dhe përftesat përkthimore në përkthimet e Prof. Xhevat Lloshi*

**Kujtim KAPLLANI**: *Kriteret e prof. Xh. Lloshit në hartimin e teksteve shkollore, 2. Prof. dr. E. Lafe për kolegët*

**Emin KABASHI**: *Kontributi i prof. Emil Lafes për Fjalorin enciklopedik shqiptar*

**Zeqirija IBRAHIMI:** *Kontributi i Xhevat Lloshit për terminologjinë e botanikës dhe zoologjisë në gjuhën shqipe*

**Agim VINCA:** *Fjalë rasti për Jubileun*

**Shpëtim ÇUÇKA**: *Për një gjuhë mbarëshoqërore të pastër, të bukur, të kulturuar (me rastin e 80-vjetorit të lindjes së gjuhëtarëve Xh. Lloshi dhe E. Lafe)*

**Viktor BAKILLARI**: *1. Udhëtim i pandalshëm i prof. Xhevat Lloshit në leksikografi arritje dhe sfida; 2. (Mirë)njohje dhe konsiderata për Profesorin klasik Emil Lafe*

**Begzad BALIU:** *Vendi i Profesor Xhavet Lloshit në studimet albanologjike*

**Idriz METANI**: *Rreth Fjalorit gjermanisht- shqip të Qiro Truelkes (1899)*

**Naim BERISHA:** *Ndihmesa e prof. Xhevat Lloshit dhe prof. Emil Lafes në veprimtarinë shkencore të Institutit Albanologjik.*

**Gani S. PLLANA - Agron DURO:** *Disa çështje të makrostrukturës së "Fjalorit të termave bazë teknikë" (shqip-gjermanisht e gjermanisht-shqip*

**Fjala e mbylljes së Konferencës**

E rrallë

# Gjykatësi në Kaliforni: Fëmijët mund të konsumojnë kanabis në kopsht



jë kopsht publik në Kaliforni mund të mbajë kanabis që përdoret për trajtimin emergjent të një forme të rrallë epilepsie. Vendimi u dha nga një gjykatës pasi ai u vendos në anën e familjes së pesëvjeçares Brooke Adams. Përdorimi i marijuanës mjekësore në privat me rekomandim të mjekut është i ligjshëm në Kaliforni.

FOTO E DITES



Turistët në provincën Zhejiang të Kinës shihen duke ngrënë drekë në një restorant të ndërtuar mbi një shkëmb në malin Longquan.

E jashtëzakonshme

# Francezi që i mban në shtëpi 400 zvarranikë



Në një shtëpi afër lumit Loire në Francë një kobra qëndron në tavolinën e kafesë, një breshkë 50 kilogramësh bredh nëpër kopsht dhe një krokodil dy metrae ruan portën. Për më shumë se dy dekada 67-vjeçari Philippe Gillet, i apasionuar për zvarranikët, ka rritur në shtëpinë e vet më shumë se 400 kafshë frikësuese, përfshirë gjarpërinj, merimanga dhe hardhuca.

## BARSOLETA E DITËS



**Dy shokë:**
**- O bir, sot një femër më tha kam shumë mall për ty!**
**- Po çka i the?**
**- Hajde ta hapim një shitore bashkë.**

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Në ora 16:00**

### "HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky







**Në ora 18:00**

### "THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson

**Në ora 20:00 dhe 22:00**

### "THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilera, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot nuk duhet të akumuloni energji negative që mund t'ju shtyjnë të merrni vendime të gabuara. Qëndroni indiferent me kolegët.



**DEMI**
Do të irritoheni nga sjellja e një personi të caktuar sot. Edhe pse ka shumë situata që duhet të sqarohen nuk mund të vendosin të tjerët për punët tuaja.



**BINJAKËT**
Të impononi sjelljet tuaja tek të tjerët nuk është gjëja më e mirë që mund të bëni sot. Do të krijohen çarje të mëdha në komunikimin me partnerin.



**GAFORRJA**
Nëse sot do të vini në plan të parë familjen, asnjë nuk do t'ju verë faj, por do të marrë si shembull sjelljen dhe përkushtimin tuaj.



**LUANI**
Pas fazave disi të zhurmshme të jetës suaj dhe të kaluara në rrëmujë të plotë, ka ardhur momenti të ktheheni me këmbë në tokë.



**VIRGJËRESHA**
Po kërkoni një udhërrëfyes sot dhe doni t'i besoni çdo gjë që ka të bëjë me punën tuaj. Nuk do ta gjeni personin e duhur, por do ta kuptoni vonë këtë gjë.



**PESHORJA**
Nuk mund t'i kombinoni gjithmonë impenjimet e punës dhe ato personale. Shumë herë duhet të zgjidhni ato që kanë më tepër rëndësi për ju.



**AKREPI**
Sot duhet ta kapni momentin për të thënë atë që po e mendoni prej kohësh. Nëse ky çast ikën nuk do t'ju jepet një mundësi e dytë.



**SHIGJETARI**
Ta rifitoni besimin e një personi që e ka humbur do të jetë qëllimi i ditës suaj sot. Do t'ju duhet shumë mund për t'i rivendosur marrëdhëniet.



**BRICJAPI**
Sot duhet të jeni të sigurt në vetvete dhe imune nga kritikat që mund t'ju vijnë nga ambiente të ndryshme.



**UJORI**
Lejoni që një person i caktuar t'ju tregojë mënyrën për të realizuar një projekt tuajin. Më vonë do të kuptoni se sa shumë interesohet për ju.



**PESHQIT**
Do t'ju duhet të kaloni shumë orë në ambientin e punës sot për të mbyllur ato gjëra që i keni lënë pezull deri në momentin që do të merrnit miratim.

# Rihanna emërohet ambasadore e Barbados



Këngëtarja Rihanna ka thënë se nuk mund të ishte më shumë krenare pasi u emërua ambasadore nga Qeveria e Barbados. Artistja, emri i së cilës është Robyn Rihanna Fenty, u emërua "Ambasadore e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë" në vendin e saj të lindjes. Roli i Rihannës përfshin promovimin e arsimit, turizmit dhe investimeve. Kryeministrja Mia Amor Mottley ka theksuar se ishte e nderuar t'i jepte titullin këngëtares.

# Pete Davidson dhe Ariana Grande sërish tatuazh të njëjtë






Pete Davidson dhe Ariana Grande kanë bërë sërish tatuazhe të njëjta. Tatua thotë 'mille tendresse', që do të thotë 'një mijë ndjeshmëri'. Ata vendosën që këto shkrime të jenë mbrapa qafës.



# Katie Price në rehabilitim për çrregullime të stresit

Katie Price është kontrolluar në një qendër rehabilitimi për vuajtjen nga çrregullimi i stresit post traumatik. Nëna e pesë fëmijëve do të trajtohet në The Priory për 28 ditë pasi familja i kërkoi të merrte ndihmë mjekësore. Modeluesja po përballet me probleme financiare dhe me divorcin nga bashkëshorti Kieran Hayler. Katie ka shfaqur çrregullime në sjellje dhe pranoi se kishte nevojë për ndihmë për PTSD.

# Justin Bieberi, më i dashuruar se kurrë



Justin Bieberi dhe e fejuara e tij Hailey Baldwin po tregojnë çdo ditë se janë më të dashuruar se kurrë pas njëri-tjetrit. Çifti është fotografuar në Itali, duke kaluar çaste romantike së bashku. 25-vjeçari Bieber duket se së shpejti do t'i japë fund beqarisë për ta kurorëzuar dashurinë e tij me Hailey. E dashura e këngëtarit kanadez dukej e mrekullueshme në jahtin luksoz, me bikini të zeza.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Montimi Servisimi Porosi
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| | |
|---|---|
| AEK LARNACA - OMONIA NICOSIA | 1 |
| JABLONEC 97 - PLZEN | GG |
| LILLESTROM - TROMSO | 1 |

# Flamurtari dhe Prishtina njoftohen me humbje



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Java e gjashtë e IPKO Superligës së Kosovës në futboll ka sjellë ndeshje interesante, kurse skuadra e Flamurtarit dhe ajo e Prishtinës janë njoftuar me humbje, pasi pësuan disfata në derbit ndaj Feronikelit, përkatësisht Dritës. Lidere e re e elitës është skuadra e Feronikelit, kurse trajneri Shpëtim Duro debuton me fitore. Fitores i është gëzuar edhe Llapi, që pati një javë mjaftë të vështirë me mosmarrëveshje në mes trajnerit Bylbyl Sokoli dhe futbollistëve. E vetmja skuadër deri me tash që ka mbetur pa asnjë pikë të grumbulluar është skuadra e KEK-ut nga Obiliqi.

## Drita - Prishtina 1-0

Trajneri Shpëtim Duro ka debutuar me fitore si trajner i Dritës, derisa kampionët aktual të Kosovës e mposhtën skuadrën e Prishtinës (1-0). Trajneri Duro e fitoi duelin e parë në Kosovë me trajnerin tjetër nga Shqipëria, Mirel Josa. Pjesa e parë e ndeshjes që u zhvillua në Gjilan përfundoi me rezultat 0-0, kurse pas një ore lojë Shala e shënoi golin e fitores. Pas kësaj xhiro, Drita grumbullon gjashtë pikë, kurse kryeqytetasit e mbesin në kuotën e 11 pikëve dhe renditën në pozitën e katërt në renditjen tabelore. Në xhiron e radhës Prishtina e pret rivalin lokal, Flamurtarin. Ndërsa edhe skuadra e skuadra e Dritës do të luajë ndaj rivaleve lokal, Gjilanit.

## Ferizaj - Gjilani 0-2

Fitores të dielën si mysafirë i është gëzuar skuadra e Gjilanit, e cila e mposhti Ferizajn me rezultat 0-2. Vendasit u mbajtën mirë në pjesën e parë të ndeshjes, por në pjesën e dytë mysafirët e morën kontrollin e lojës dhe shënuan golin e parë në minutën e 62-të, nëpërmjet Wilber Peres. Rezultatin final 2-0 e vulosi tre minuta para fundit të ndeshjes Edon Sadriu. Ferizajn në xhiron e shtatë i shkon Trepçës '89.

## Flamurtari - Feronikeli 1-3

Flamurtari ka pësuar humbjen e parë pas gjashtë javësh në elitën e futbollit të Kosovës. Kryeqytetasit e drejtuar nga Arsim Thaqi, të shtunën pësuan humbje nga Feronikeli, i cili falë tri pikëve të marra në këtë ndeshje e rrëmbejë pozitën e liderit. Skuadra nga Drenasi kaloi në epërsi në minutën e 13-të me golin e shënuar nga Mendurim Hoti, dhe me rezultatin 0-1 përfundoi pjesa e parë e ndeshjes. Në fillim të pjesës së dytë, Flamurtari u rikthye në lojë duke barazuar rezultatin në 1-1, autor i golit ishte Alban Shillova. Carioca Da Silvas pas një ore lojë e riktheu epërsinë e mysafirëve, derisa Artur Magani (69) e vulosi rezultatin final 1-3.

## Liria - Llapi 2-3

Llapi i ka tejkaluar problemet që kishte gjatë gjithë javës në mes futbollistëve dhe trajnerit dhe arriti fitore ndaj Lirisë në Prizren, me rezultat 2 me 3. Liridon Fetahaj në minutën e 14-të, por gjashtë minuta më vonë Festim Alidemaj e barazoi rezultatin në 1 me 1. Vendasit pesë minuta para fundit të pjesës së parë e rikthyen sërish epërsinë në 2-1, me golin e Egzon Sinanit. Në pjesën e dytë mysafirët ishin më këmbëngulës dhe shënuan edhe dy gola të tjerë nëpërmjet Festim Alidemës (62', 70') për rezultatin final 2-3.

## KEK-u - Drenica 2-4

Fitores të shtunën iu gëzua edhe Drenica që ishte mysafire e KEK-ut (2-4).
Për vendasit realizuan Ardit Gashi (57) dhe Shpëtim Preniqi (90), kurse për mysafirët shënoi Armend Abazi (12), Vigan Rexhaj (45), Taulant Dajaku (75) dhe Kreshnik Uka (88). Drenica ndeshjen e radhës e pret Ballkanin, kurse KEK-u i shkon Llapit në "Zahir Pajaziti".

### Lista e golashënuesve

| | | |
|---|---|---|
| 1. Alban Shillova | (Flamurtari) | 6 gola |
| 2. Festim Alidema | (Llapi) | 4 |
| 3. Liridon Fetahaj | (Liria) | 4 |
| 4. Mendurim Hoti | (Feronikeli) | 4 |
| 5. Qëndrim Gashi | (Liria) | 3 |
| 6. Fatih Karahoda | (Liria) | 3 |
| 7. Mentor Zhdrella | (Llapi) | 3 |
| 8. Ahmet Januzi | (Llapi) | 3 |
| 9. Betim Haxhimusa | (Drita) | 2 |
| 10. Endrit Krasnmiqi | (Drita) | 2 |

### IPKO SUPERLIGA

| | |
|---|---|
| Ferizaj - Gjilani | 0-2 |
| Drita - Prishtina | 1-0 |
| Liria - Llapi | 2-3 |
| KEK-u - Drenica | 2-4 |
| Flamurtari - Feronikeli | 1-3 |
| Ballkani - Trepça '89 | 0-0 |

### Tabela

| | | |
|---|---|---|
| 1. Feronikeli | 6 | 14 pikë |
| 2. Llapi | 6 | 13 |
| 3. Flamurtari | 6 | 13 |
| 4. Prishtina | 6 | 11 |
| 5. Gjilani | 6 | 10 |
| 6. Drenica | 6 | 9 |
| 7. Ballkani | 6 | 8 |
| 8. Trepça '89 | 6 | 6 |
| 9. Liria | 6 | 6 |
| 10. Drita | 6 | 6 |
| 11. Ferizaj | 6 | 4 |
| 12. KEK-u | 6 | 0 |

Në xhiron e radhës takohen: Feronikeli - Liria, Llapi - KEK-u, Gjilani - Drita, Trepça '89 - Ferizaj, Drenica - Ballkani, Prishtina - Flamurtari.

### LIGA E PARË

| | |
|---|---|
| Vllaznia - 2 Korriku | 0-2 |
| Kika - Drenasi | 1-1 |
| Arbëria - Dukagjini | 3-6 |
| Besa - Istogu | 3-2 |
| Trepça - Bashkimi (K) | 2-1 |
| Vitia - Vushtrria | 1-1 |
| Onix - Fushë-Kosova | 0-0 |
| Vëllaznimi - Ramiz Sadiku | 2-0 |

### Tabela

| | | |
|---|---|---|
| 1. Vëllaznimi | 5 | 11pikë |
| 2. Dukagjini | 5 | 11 |
| 3. Onix | 5 | 11 |
| 4. Besa | 5 | 10 |
| 5. Vushtrria | 5 | 10 |
| 6. Arbëria | 5 | 9 |
| 7. Kika | 5 | 8 |
| 8. Vitia | 5 | 8 |
| 9. Fushë-Kosova | 5 | 7 |
| 10. Trepça | 5 | 6 |
| 11. Bashkimi (K) | 5 | 5 |
| 12. Drenasi | 5 | 5 |
| 13. Ramiz Sadiku | 5 | 3 |
| 14. Istogu | 5 | 3 |
| 15. 2 Korriku | 5 | 3 |
| 16. Vllaznia | 5 | 1 |

## SHKURT

### Fabiana Bytyqi, kampione e botës në boks

Fabiana Bytyqi sonte ka fituar titullin kampione bote në boks. Shqiptarja 22-vjeçare me nënshtetësi të Çekisë për 10 raunde u ndesh me britaniken Denise Castle. Bytyqi dhe Castle u ndeshen në kategorinë atom për titullin e më të mirës në botë në nivelin WBC. Me vendimin e jurisë, Fabiana Bytyqi u shpall kampione bote në boks në WBC.

### Shkëndija fiton ndaj Sileksit

Skuadra e Shkëndijës ka arritur të marrë një fitore me shumë vështirësi, por në fund ato që kanë rëndësi janë pikët. Ekipi i drejtuar nga trajneri Osmani ka fituar me rezultatin 1-2 në trasnfertën e vështirë përballë skuadrës së Sileks Kratovo. Golat për fitoren e ekipit kuqezi nga Tetova i shënuan Bojku dhe Ibrahimi, kurse për vendësit realizoi Grozdanoski. Edhe Akademija Pandev ka fituar përballë Pobedës në transfertë me rezultatin 2-4.

### Fitojnë favoritët në hendboll

Fitore bindëse kanë shënuar katër skuadrat që llogariteshin favorite për ndeshjet e javës së dytë të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Kampionia në fuqi, Besa Famgas, fitoi ndaj skuadrës së kthyer në Superligë, Drenicës, me rezultat 33:18. Kastrioti në Ferizaj fitoi edhe më thellë ndaj Trepçës. Rezultati në fund të takimit ishte 41:20 në të mirë të ferizajasve. Drita e ka fituar derbin gjilanas ndaj Zhegrës me rezultat 46:28. Fitoren e parë e ka shënuar Prishtina, që në xhiron e parë pësoi nga Drita. Prishtina pa ndonjë vështirësi arriti te fitorja ndaj Samadrexhës me rezultat 38:20. Për dallim nga këto katër ndeshje, takimi i luajtur në Vushtrri në mes të Vushtrrisë e Vëllaznimit ishte dramatik. Në fund kjo ndeshje nuk dha fitues, pasi përfundoi me rezultat 27:27.

### Prishtina eliminohet nga Liga e Kampionëve

